

Rekomandimi nr.17 i Politikës
së Përgjithshme të ECRI-t
**për parandalimin dhe luftën kundër
intolerancës dhe diskriminimit ndaj
personave LGBTI**



Miratuar më 28 qershor 2023

Strasburg, 28 shtator 2023

Përkthimi është bashkëfinancuar
nga Bashkimi Evropian



European Commission
against Racism and Intolerance

ECRI
Commission européenne
contre le racisme et l'intolérance

COUNCIL OF EUROPE



**Rekomandimi
nr.17 i Politikës
së Përgjithshme
të ECRI-t
për parandalimin dhe
luftën kundër
intolerancës dhe
diskriminimit ndaj
personave LGBTI**

**Miratuar më 28 qershor 2023
Strasburg, 28 shtator 2023**

Këshilli i Evropës

Botimi në frëngjisht: *Recommandation de politique générale n° 17 de l'ECRI sur la prevention et la lutte contre*

l'intolerance et la diskriminim envers les personnes LGBTI

Mendimet e shprehura në këtë punim janë përgjegjësi e autorit(autorëve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.

Ky përkthim u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Këshillit të Evropës dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian..

Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë), përveçse për qëllime komerciale për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmenti nuk përdoret jashtë kontekstit, nuk jep informacion të paplotë ose përndryshe nuk e keqorienton lexuesin për natyrën, qëllimin ose përmbajtjen e tekstit. Teksti burimor duhet të njihet gjithmonë si më poshtë “© Këshilli i Evropës, viti i botimit”. Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me riprodhimin/përkthimin e të gjithë ose një pjese të dokumentit, duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Komunikimeve, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasbourg Cedex ose publishing@coe.int).

Të gjitha korrespondencat e tjera në lidhje me këtë dokument duhet t'i drejtohen Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) Departamenti i Këshillit të Evropës, Këshilli i Evropës, F-67075 Strasbourg Cedex. E-mail: ecri@coe.int

Dizajni i kapakut dhe paraqitjes: Documents and Publications Production Department (DPDP), Council of Europe

Foto: © EnvatoElements

Ky botim nuk është kopjuar-redaktuar nga Njësia editoriale e PDDP-së për të korrigjuar gabimet drejtshkrimore dhe gramatikore.

© Këshilli i Evropës, Shtator 2023

Botuar nga Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI)
Këshilli i Evropës - 2023 Strasbourg

Përmbajtja

HYRJE	5
I. SFONDI HISTORIK	9
II. AVANCIMI DREJT RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE TË NJERIUT TË PERSONAVE LGBTI NË EVROPË 11	
III. SFIDAT E VAZHDUESHME PËR TË DREJTAT E NJERIUT TË PERSONAVE LGBTI NË ZONËN E KËSHILLIT TË EVROPËS	17
Mungesa e të dhënave të besueshme dhe politikave adekuate	17
Nevoja për masa më të vendosura në fushën e arsimit gjithëpërfshirës	19
Mungesa e njohjes formale dhe mbrojtjes së çifteve të të njëjtit seks dhe lidhjeve familjare LGBTI	20
Mos-sigurimi i njohjes ligjore të gjinisë dhe mbrojtjes së personave transgjjinorë	21
Mungesa e garancive ligjore për personat interseks	22
Të drejtat e fëmijëve dhe ekspozimi i personave LGBTI ndaj praktikave të konvertimit	22
Trajtimi i papërshtatshëm i kërkesave për azil nga personat LGBTI	23
Rritja e gjuhës së urrejtjes kundër LGBTI dhe të ashtuquajturat fushata kundër gjinisë	24
Mungesa e përgjegjshmërisë për aktet e gjuhës së urrejtjes kundër LGBTI-së dhe dhunës së motivuar nga urrejtja	25
REKOMANDIME	27
Parimet e përgjithshme	27
Politikat dhe Koordinimi Institucional	29
Parandalimi	33
Mbrojtja	35
Hetimi, ndjekja penale dhe masat e ligjit procedural	36
BIBLIOGRAFIA	39
Këshilli i Evropës	39
Bashkimi Evropian	42
Legjislacioni kombëtar dhe praktika gjyqësore	43
Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD)	43
Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB)	44

Hyrje

1. Mandati dhe synimi i ECRI-t me këtë Rekomandim të Politikës së Përgjithshme (GPR) është që të punojë për të parandaluar dhe luftuar diskriminimin dhe intolerancën ndaj lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve, transgjignorëve dhe personave interseks¹ (LGBTI²) dhe të ndihmojë në zhvillimin e një shoqërie që është gjithëpërfshirëse e personave LGBTI.³ Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet se, ndërsa GPR i ECRI-t i drejtohet autoriteteve kombëtare të shteteve anëtare, parandalimi dhe lufta kundër diskriminimit dhe intolerancës ndaj personave LGBTI dhe zhvillimi i një shoqërie gjithëpërfshirëse duhet të kuptohet si përgjegjësi e të gjithë anëtarëve të shoqërisë.

2. Në të gjithë zonën e Këshillit të Evropës, personat LGBTI ende përjetojnë shkallë të lartë diskriminimi dhe abuzimi, përfshirë dhunën, për shkak të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikave seksuale.⁴ Ka persona që gjithashtu mund t'i nënshtrohen diskriminimit dhe abuzimit për

¹ Personat interseks lindin me karakteristika seksuale biologjike që nuk përputhen me normat shoqërore apo përkufizimet mjekësore të asaj që e bën një person mashkull apo femër. Interseksi shfaqet në shumë forma. Është një term spektër ose ombrellë, dhe jo një kategori e vetme. Për një diskutim dhe shpjegim të plotë të terminologjisë LGBTI, ju lutemi të shihni Fjalorin e ECRI-t që e gjeni në faqen e internetit të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancë <https://www.coe.int/en/web/European-commission-against-racism-and-intolerance/ecri-glossary>

² Ndërsa termi "LGBTI" u referohet në mënyrë specifike personave lesbike, homoseksualë, biseksualë, transgjignorë dhe interseks, Rekomandimi i Politikës së Përgjithshme nr. 17 duhet të kuptohet që përfshin të gjithë njerëzit, përfshirë popullsinë jo-binare, që përjetojnë diskriminim, dhunë dhe intolerancë për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor ose karakteristikave seksuale

³ ECRI ka trajtuar intolerancën dhe diskriminimin ndaj personave LGBT që në vitin 2013, kur filloi ciklin e tij të pestë të monitorimit të shtetit. Brenda Këshillit të Evropës, ECRI u inkurajua të angazhohej me të drejtat e personave LGBT pas miratimit nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës të Rekomandimit CM/Rec(2010)5 mbi masat për të luftuar diskriminimin për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor. Gjatë hartimit të listës së fushave prioritare për ciklin e tij të gjashtë të monitorimit të shtetit dhe pas dialogut si me aktorët e shoqërisë civile ashtu edhe me organet e barazisë në shtetet anëtare, ECRI vendosi të përfshijë më tej të drejtat e personave interseks dhe diskriminimin për shkak të karakteristikave seksuale, si pjesë e punës së tij. Në vitin 2021, Sekretariati i ECRI-t publikoi një Fletë Informuese mbi çështjet e LGBTI-së dhe, përmes punës së tij monitoruese të shtetit, ECRI ka miratuar një qasje të qëndrueshme si për identifikimin ashtu edhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave LGBTI.

⁴ Në përputhje me Fjalorin e ECRI-it (2023), ECRI kupton se *orientimi seksual* i referohet aftësisë së çdo personi për tërheqje të thellë emocionale, afëksioni dhe seksuale ndaj, dhe marrëdhënieve intime dhe seksuale me, individë të një gjinie të ndryshme ose të së njëjtës gjini ose më shumë se një gjini. Sipas ECRI-t identiteti gjinor i referohet përvojës së brendshme dhe individuale të çdo personi të gjinisë, e cila mund ose mund të mos i korrespondojë seksit të caktuar në lindje, duke përfshirë ndjesinë personale të trupit (e cili mund të përfshijë, nëse zgjidhet lirisht, modifikimin e paraqitjes ose funksionimit të trupit me mënyra mjekësore, kirurgjikale ose të tjera). E rëndësishme është që identiteti gjinor përfshin gjithashtu shprehjet e gjinisë, sidomos veshjen, të folurit dhe sjelljet. ECRI kupton karakteristikat seksuale si të tilla që i referohen veçorive kromozomike, gonadale dhe anatomike të një personi, të cilat përfshijnë karakteristikat kryesore seksuale, si organet e riprodhimit dhe organet gjenitale, dhe/ose në strukturat kromozomike dhe hormonet; dhe karakteristikat dytësore seksuale, si masa muskulore, gjoksi dhe/ose struktura.

shkak të shoqërimit me personat LGBTI dhe/ose për shkak të orientimit të tyre të perceptuar seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikave seksuale. Intoleranca kundër personave LGBTI shfaqet në mënyra komplekse dhe të larmishme dhe pasojat e saj ndikojnë negativisht në identitetet ligjore, sociale, politike dhe kulturore të personave LGBTI.

3. Nuk ka popullatë LGBTI monolite apo njëdimensionale në Evropë. Megjithatë, lesbiket, homoseksualët, biseksualët, transgjinorët dhe personat interseks vuajnë nga diskriminimi dhe intoleranca, të cilat mund të jenë të rrënjosura në probleme të përbashkëta si seksizmi, mizogjinia, patriarkalizmi dhe bindjet e ngurta për identitetin, trupin, seksualitetin dhe rolet gjinore. Ndërsa shumë lesbike, homoseksualë, biseksualë, transgjinorë dhe persona interseks identifikohen nën ombrellën më të gjerë LGBTI, persona të tjerë mund të besojnë se një term gjithëpërfshirës "LGBTI" nuk pasqyron mjaftueshëm specifikën e përvojave të tyre të jetuara.

4. Në hartimin e masave për të luftuar diskriminimin dhe intolerancën ndaj personave LGBTI, politikë bërësit (lokal/rajonale dhe kombëtare) duhet të marrin parasysh diversitetin që ekziston ndërmjet orientimeve seksuale, identiteteve gjinore dhe karakteristikave seksuale në Evropë. Kjo përfshin njohjen e personave që përfshihen brenda më shumë se një nën-kategori LGBTI dhe që mund të përjetojnë forma të ndryshme të intolerancës dhe diskriminimit. Në veçanti, ECRI njihet përvojat unike, sfidat dhe dobësitë me të cilat përballen gratë lesbike, biseksuale, transgjinore dhe interseks. Gjithashtu duhet të kuptohet që ndërsa strategjitë për të ndihmuar një grup ndërmjet popullatës më të gjerë LGBTI, të tillë si homoseksualët apo lesbiket, nuk minojnë të drejtat e popullatave të tjera, si personat transgjinorë dhe interseks, këto strategji mund të mos adresojnë nevojat specifike të atyre grupeve të tjera. Autoritetet duhet të jenë vigjilente ndaj kërkesave të të gjithë njerëzve dhe grupeve që përjetojnë diskriminim dhe intolerancë bazuar në orientimin seksual aktual ose të perceptuar, identitetin gjinor ose karakteristikat seksuale.

5. Të qenit LGBTI gjithashtu nuk mund të ndahet nga karakteristikat e tjera, sidomos "raca",⁵ origjina etnike ose kombëtare, shtetësia, feja, gjinia dhe statusi i aftësisë së kufizuar.⁶ Shkalla në të cilën një person LGBTI mund të përballlet me intolerancë për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor ose

⁵ Meqenëse të gjitha qeniet njerëzore i përkasin të njëjtit lloj, ECRI hedh poshtë teoritë e bazuara në ekzistencën e "racave" të ndryshme (shihni, në këtë kontekst, Opinionin e ECRI-t mbi konceptin e "racializimit", 2021).

⁶ Mandati i ECRI-t shtrihet në shkaqet e "racës", origjinës etnike/kombëtare, ngjyrës, shtetësisë, fesë, gjuhës, orientimit seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikave seksuale. Megjithatë, ECRI pranon se personat LGBTI mund të përjetojnë diskriminim për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor ose karakteristikave seksuale, që gjithashtu ndërthuren me karakteristikat e tjera të cilat nuk janë pjesë e mandatit të tij, sidomos aftësia e kufizuar, klasa, gjinia, mendimi politik ose tjetër, prejardhja shoqërore, prona, mosha dhe lindja. ECRI, duke u fokusuar në karakteristikat që janë shqetësuese, nuk duhet të kuptohet sikur nënkupton ekzistencën e ndonjë hierarkie diskriminimi ose shkaqeve të mbrojtura. Përkundrazi, ECRI e kupton se si këto karakteristika shtesë mund të formojnë, të ndryshojnë dhe të komplikojnë mënyrat se si personat LGBTI përjetojnë diskriminim dhe intolerancën në zonën e Këshillit të Evropës.

karakteristikave seksuale mund të formësohet në mënyrë të konsiderueshme, të ndryshohet ose të ndërlikohet nga aspekte të tjera kyçe të identitetit ose realiteteve të jetuara, siç është statusi i refugjatit ose përkatësia në komunitetet Rome ose Udhëtare. Në fillim të këtij GPR, ECRI pohon se, në përpjekje për të trajtuar në mënyrë efektive luftën kundër dhunës dhe diskriminimit të personave LGBTI, është e rëndësishme të trajtohen në mënyrë eksplicite mënyrat e shumta se si fobia ndaj LGBTI-së ndërthuret me fenomene të tjera, sidomos racizmin, ksenofobinë, seksizmin, paragjykimin ndaj aftësisë së kufizuar dhe intolerancën fetare.

I. Sfondi historik

6. Në mbarë Evropën, të drejtat e njeriut të personave LGBTI kanë njohur histori komplekse dhe shqetësuese.⁷ Historikisht, lesbiket, homoseksualët, biseksualët, transgjinatorët dhe personat interseks kanë qenë subjekt i stigmatizimit, pabarazisë dhe dhunës. Ata janë persekutuar, përjashtuar dhe burgosur, sidomos burgosja në kampet naziste të përqendrimit gjatë Luftës së Dytë Botërore.

7. Në shumë pjesë të Evropës, aktiviteti seksual me konsensus ndërmjet personave të të njëjtit seks vazhdoi të ishte vepër penale deri në fund të shekullit të njëzetë. Këto legjislacione penale, të cilat shpesh interpretoheshin dhe zbatoheshin gjerësisht, jo vetëm që u mohonin njerëzve të drejtën për t'u përfshirë në aktet më elementare të vetë-shprehjes fizike dhe emocionale, por ato u përdorën gjithashtu si justifikim në diskursin politik dhe në diskursin tjetër publik për persekutim më të gjerë sidomos shantazh, ngacmim dhe dhunë.

8. Ndërsa ligjet që kriminalizonin homoseksualitetin më së shumti ishin kundër intimitetit ndërmjet meshkujve të të njëjtit seks, ekzistenca e tyre legjitimonte gjithashtu abuzimin social dhe ligjor ndaj grave lesbike dhe biseksuale. Gjithashtu, ndryshe nga armiqësia më e pakët ndaj seksualitetit femëror të të njëjtit seks krahasuar me homoseksualët ose biseksualët, përjashtimi nga ligji penal i intimitetit femëror të të njëjtit seks ilustron se si në Shtetet anëtare seksualiteti i lesbikeve shpesh me forcë fshihej, shtypej dhe i nënshtrohej rregullimit shoqëror, duke përfshirë presionin për të hyrë në marrëdhënie të seksit të ndryshëm. Ashtu si të gjitha gratë, lesbiket dhe biseksualet ishin subjekt i diskriminimit strukturor, si kufizimet ndaj pronësisë dhe punësimit, të cilat mund të kenë vepruar si barriera për ndjekjen e marrëdhënieve intime ndërmjet të njëjtit seks.

9. Ligjet penale u përdorën gjithashtu për të censuruar personat e tjerë transgjinatorë, jobinarë⁸ dhe persona të tjerë jokonformues gjinorë, veçanërisht përmes ligjeve kundër veshjes së seksit tjetër, të cilat u mohonin njerëzve të drejtën për të shfaqur publikisht dhe për të shprehur identitetin e tyre gjinor,

⁷ Diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor në Evropë, botimi i dytë, (Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, Publikim i Këshillit të Evropës, 2011), 21-35.

⁸ Jo-binar duhet të kuptohet si një term ombrellë për identitetet gjinore që qëndrojnë jashtë binarit gjinor mashkull apo femër. Këtu përfshihen persona, identiteti gjinor i të cilëve nuk është ekskluzivisht mashkull e as femër, një kombinim i mashkullit dhe femrës ose ndërmjet ose përtej gjinive. Njësoj si me përdorimin e transgjinatorëve, njerëzit nën ombrellën jo-binare mund ta përshkruajnë veten duke përdorur një ose më shumë nga një larmi e gjerë termash. Për qëllimet e GPR Nr.17, termi "transgjinor" duhet të kuptohet se përfshin njerëzit jo-binarë.

dhe përmes zbatimit diskriminues të ligjeve kundër grumbullimeve, të cilat synonin në mënyrë disproporcionale personat transgjinorë në ekonominë informale dhe transgjinorët të cilëve u mungonte një status i rregullt strehimi.

10. Përndryshe, jashtë ligjit penal, shpesh personat LGBTI ishin të padukshëm. Dispozitat e së drejtës civile dhe administrative për barazinë, kur u prezantuan, shpesh e hiqnin orientimin seksual, identitetin gjinor dhe karakteristikat seksuale. Personat LGBTI mund të pushohen nga puna, të ndahen nga familjet e tyre, të dëbohen nga shtëpitë e tyre, të largohen nga shkollat e tyre dhe t'u mohohen mallrat dhe shërbimet bazë – të gjitha pa asnjë zgjidhje ligjore. Nuk njiheshin lidhjet familjare ndërmjet të njëjtit seks dhe personat LGBTI shpesh përpiqeshin të siguronin edhe të drejtat themelore për vetëvendosje dhe paprekshmëri trupore.

II. Avancimi drejt respektimit të të drejtave të njeriut të personave LGBTI në Evropë

11. Përkundër kësaj historie shqetësuese, ECRI mirëpret faktin që, vitet e fundit, ka pasur përparime të rëndësishme në të gjithë zonën e Këshillit të Evropës, duke përfshirë dekriminalizimin formal të marrëdhënieve seksuale ndërmjet të njëjtit seks në të gjitha shtetet anëtare. Ky përparim drejt respektimit më të madh të të drejtave të njeriut të personave LGBTI është i dukshëm në të gjitha nivelet e shoqërisë evropiane – juridike, politike, sociale dhe kulturore, edhe pse në shkallë të ndryshme ndërmjet shteteve anëtare.

12. Ka të dhëna për rritje të ndërgjegjësimit dhe pranimit më të madh të personave LGBTI. Mbarë publiku, veçanërisht brezat e rinj, jo vetëm që kanë më shumë gjasa të kenë njohuri për çështjet që prekin personat LGBTI, por gjithashtu kanë kontakte në rritje me personat LGBTI në rrjetet e tyre personale dhe profesionale.

13. Si shembull, në vitin 2019, sondazhi i Eurobarometrit Special 493 i Komisionit të BE-së identifikoi mbështetje në rritje në 28 vendet e atëhershme të Bashkimit Evropian për barazinë bazuar në orientimin seksual, martesën ndërmjet të njëjtit seks dhe pranueshmërinë e marrëdhënieve të të njëjtit seks.⁹ Kjo njohje-përmes-afërsisë ka qenë një faktor kyç në shembjen e mureve të përjashtimit për personat LGBTI dhe ka shërbyer si një katalizator për biseda më të gjera publike rreth diversitetit në orientimin seksual, identitetin gjinor dhe karakteristikat seksuale.

14. Paralelisht me këto qëndrime sociale të ndryshueshme, dhe ndoshta si pasojë e tyre, ka pasur edhe një rritje të vizibilitetit të personave LGBTI të shfaqur brenda sferës publike. Për shembull, një numër në rritje i politikanëve Evropian identifikohen si LGBTI, përfshirë disa prej tyre që kanë shërbyer si Krerë të Qeverisë ose si Krerë të Shtetit në vendin e tyre. Zgjedhja e përfaqësuesve publik LGBTI jo vetëm që ka një rëndësi simbolike të rëndësishme, por gjithashtu rrit mundësinë që zërat dhe përvojat e LGBTI-së të merren parasysh kur miratohen politikat lokale, rajonale dhe kombëtare.

15. Në kontekstin e reformës ligjore, në tre dekadat e fundit janë parë ndryshime mjaft të shpejta në lidhje me të drejtat e njeriut të personave LGBTI

⁹ Eurobarometri Special 493 – Diskriminimi në Evropë: Raport Publikimi (Komisioni i Bashkimit Evropian, 2019), 122-127.

në disa shtete anëtare. Nga një pozicion ku ndalimet penale vazhduan të hidhnin hije mbi jetët e personave LGBTI, një numër i konsiderueshëm vendesh kanë miratuar mbrojtje ligjore kundër diskriminimit, gjuhës së urrejtjes dhe dhunës së motivuar nga urrejtja ndaj personave LGBTI.

16. Progresi ligjor në të gjithë Evropën ka rezultuar në barazi më të madhe për personat LGBTI në fusha të gjera të jetës së përditshme, duke përfshirë punësimin, kujdesin shëndetësor, arsimin dhe strehimin.¹⁰ Ligjet kundër diskriminimit brenda shteteve anëtare shtrihen gjithnjë e më shumë për të mbuluar personat transgjinorë. Gjithashtu, deri në vitin 2023, 39 vende brenda zonës së Këshillit të Evropës ofruan procedura për të siguruar njohjen ligjore të gjinisë.¹¹

17. Brenda të drejtës familjare, e cili ka qenë prej kohësh një pengesë kryesore për barazinë me LGBTI, që nga shkurti 2023, 30 shtete anëtare të Këshillit të Evropës i dhanë një formë statusi ligjor lidhjeve të marrëdhënieve ndërmjet çifteve të të njëjtit seks. Përveç kësaj, 19 nga këto shtete lejuan martesat ndërmjet të njëjtit seks. Partneritetet e regjistruara u lejuan për herë të parë në Evropë në vitin 1989, ndërsa martesat e para ndërmjet të njëjtit seks në vitin 2001. Një numër në rritje i shteteve anëtare tani njohin ligjërisht personat LGBTI si prindër dhe u japin atyre të drejta dhe përgjegjësi të plota prindërore.

18. Në dekadat e fundit, institucionet e Këshillit të Evropës kanë luajtur një rol të rëndësishëm në avancimin e të drejtave të njeriut të personave LGBTI. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në veçanti, ka nxjerrë një sërë vendimesh kyçe mbi orientimin seksual dhe identitetin gjinor, duke nxitur reformën në të gjithë Evropën dhe më gjerë. Nga vendimet historike në *Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar*¹² dhe *Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar*,¹³ të cilat konfirmuan se ligjet që kriminalizojnë homoseksualitetin dhe ndalimet absolute për njohjen ligjore të gjinisë janë të papajtueshme me nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), GJEDNJ ka identifikuar të drejta të shumta që personat LGBTI duhet të gëzojnë

¹⁰ *Ligji për Diskriminimin për Orientim Seksual jashtë Tregut të Punës* (Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, 2020); *Të drejtat e barazisë trans dhe interseks në Evropë – një analizë krahasuese* (Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, 2018)

¹¹ *Zbatimi i Rekomandimit CM/Rec(2010)5 të Komitetit të Ministrave për masat e luftës kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor - Raporti Tematik mbi Njohjen Ligjore të Gjinisë në Evropë*, GT-ADI-SOGI(2022)7, Komiteti Drejtues për luftën ndaj Diskriminimit, Diversitetin dhe Përfshirjen (CDADI) – Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, Grupi i Punës për orientimin seksual, identitetin gjinor, shprehjen gjinore dhe karakteristikat seksuale (GT-ADI-SOGI).

¹² Kërkesa Nr. 7525/7 (GJEDNJ, 22 tetor 1981).

¹³ Kërkesa Nr. 28957/95 (GJEDNJ, 11 korrik 2002).

pavarësisht nga orientimi seksual apo identiteti gjinor.¹⁴ Kjo praktikë gjyqësore është përforcuar gjithashtu nga vendime të rëndësishme të Komitetit Evropian të të Drejtave Sociale mbi diskriminimin në edukimin e shëndetit seksual dhe riprodhues,¹⁵ dhe mbi sterilizimin e vendosur si parakusht për njohjen ligjore të gjinisë.¹⁶

19. Të drejtat e theksuara nga GJEDNJ në rastet që përfshijnë kërkues LGBTI ose njerëz që mbështesin barazinë LGBTI variojnë nga mbrojtja kundër trajtimit degradues, sidomos mbrojtja kundër gjuhës së urrejtjes dhe dhunës ndaj LGBTI,¹⁷ dhe detyrimet pozitive për të hetuar në mënyrë efektive çdo trajtim të tillë,¹⁸ e drejta për liri dhe siguri,¹⁹ e drejta për lirinë e shprehjes (në lidhje me promovimin e të drejtave të njeriut të personave LGBTI),²⁰ e drejta për lirinë e tubimit dhe organizimit paqësor,²¹ dhe e drejta për njohje ligjore të gjinisë pa kërkesa abuzive.²² Në sferën e mbrojtjes së të drejtës për jetën familjare, GJEDNJ ka qenë veçanërisht aktive, duke konfirmuar se transgjinatorët²³ dhe çiftet e të njëjtit seks²⁴ mund të gëzojnë jetën familjare, duke zgjeruar mbrojtjen e barazisë për çiftet e të njëjtit seks në fusha, si trashëgimia e qirasë,²⁵ e drejta për sigurimin shëndetësor,²⁶ lejet e qëndrimit²⁷ dhe

¹⁴ *Salgueiro da Silva Mouta kundër Portugalisë*, Kërkesa Nr. 33290/96 (GJEDNJ, 21 dhjetor 1999); *Identoba dhe të tjerë kundër Gjeorgjisë*, Kërkesa 73235/12 (GJEDNJ, 12 maj 2015); Shihni në përgjithësi Fletën Informuese të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mbi *Homoseksualitetin: Aspektet Kriminale, Çështjet e Orientimit Seksual dhe Identitetit Gjinor* në “Fletë informuese” (faqja e internetit e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut), <https://www.echr.coe.int/Pages/home.aspx?p=press/factsheets&c>. Shihni gjithashtu Fletët Informuese Tematike të Departamentit për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, mbi të drejtat e personave LGBTI <https://rm.coe.int/thematic-factsheet-lgbti-eng/1680a3b2d7>.

¹⁵ *Qendra Ndërkombëtare për Mbrojtjen Ligjore të të Drejtave të Njeriut (INTERIGHTS) kundër Kroacisë*, Kërkesa nr. 45/2007 (2009).

¹⁶ *Transgender Evrope dhe ILGA-Evrope kundër Republikës Çeke*, Kërkesa nr. 117/2015 (2018).

¹⁷ *Oganezova kundër Armenisë*, Kërkesa Nr. 71367/12, Kërkesa Nr. 72961/12 (GJEDNJ, 15 maj 2022).

¹⁸ *Identoba dhe të tjerë kundër Gjeorgjisë*, Kërkesa Nr. 73235/12 (GJEDNJ, 12 maj 2015).

¹⁹ Shihni p.sh. *OM kundër Hungarisë*, Kërkesa Nr. 9912/15 (GJEDNJ, 5 korrik 2016).

²⁰ *Bayev dhe të tjerë kundër Rusisë*, Kërkesa Nr. 67667/09 (GJEDNJ, 20 qershor 2017).

²¹ *Bjczkowski dhe të tjerë kundër Polonisë*, Kërkesa Nr. 1543/06 (GJEDNJ, 3 maj 2007).

²² *AP, Garcon dhe Nicot kundër Francës*, Kërkesa Nr. 79885/12 (GJEDNJ, 06 prill 2017); *X dhe Y kundër Rumanisë*, Kërkesa Nr. 2145/16 (GJEDNJ, 19 janar 2021).

²³ *X, Y dhe Z kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa Nr. 21830/93 (GJEDNJ, 22 prill 1997).

²⁴ *Schalk dhe Kopf kundër Austrisë*, Kërkesa Nr. 30141/04 (GJEDNJ, 22 nëntor 2010).

²⁵ *Karner kundër Austrisë*, Kërkesa Nr. 40016/98 (GJEDNJ, 24 korrik 2003).

²⁶ *PB dhe JS kundër Austrisë*, Kërkesa Nr. 18984/02 (GJEDNJ, 22 tetor 2010).

²⁷ *Taddeucci dhe McCall kundër Italisë*, Kërkesa Nr. 51362/09 (GJEDNJ, 30 qershor 2016).

birësimet,²⁸ dhe duke pranuar se shtetet palë të KEDNJ-së kanë detyrimin të ofrojnë njohje ligjore dhe mbrojtje për çiftet e të njëjtit seks.²⁹

20. Kontributi i GJEDNJ-së në avancimin e të drejtave të njeriut të personave LGBTI është përforduar përmes punës së organeve dhe institucioneve të tjera brenda Këshillit të Evropës. Në vitin 2010, Komiteti i Ministrave nxori Rekomandimin e tij kryesor CM/Rec(2010)5 mbi masat për të luftuar diskriminimin për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor. Në këtë rekomandim, Komiteti i Ministrave u bëri thirrje veçanërisht shteteve anëtare të “sigurojnë që masat legislative dhe të tjera të miratohen dhe të zbatohen në mënyrë efektive për të luftuar diskriminimin për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, për të garantuar respektimin e të drejtave të njeriut të lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transgjinorëve dhe për të nxitur tolerancën ndaj tyre.”³⁰

21. Rekomandime të ngjashme janë miratuar edhe nga institucione të tjera të Këshillit të Evropës. Vitet e fundit, Asambleja Parlamentare ka nxjerrë rezoluta, ndër tema të tjera, për barazinë për transgjinorët³¹ dhe personat interseks³², të drejtën për jetë private dhe familjare pavarësisht nga orientimi seksual,³³ dhe luftën ndaj urrejtjes në rritje ndaj personave LGBTI.³⁴

22. Kjo punë është përforduar nga rezolutat e Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, i cili u bën thirrje gjithnjë e më shumë autoriteteve lokale dhe rajonale të mbrojnë personat LGBTI,³⁵ dhe që ka pohuar se “as vlerat (kulturore, tradicionale apo fetare), as rregullat e një 'kulture dominuese' në shtete të veçanta nuk mund të përdoren për të

²⁸ *X dhe të tjerë kundër Austrisë*, Kërkesa Nr. 19010/07 (GJEDNJ, 19 shkurt 2013). Në lidhje me të drejtat e prindërve transgjinorë, shihni: *AM dhe të tjerë kundër Rusisë*, Kërkesa Nr. 47220/19 (GJEDNJ, 06 korrik 2021).

²⁹ Oliari dhe të tjerë kundër Italisë, Kërkesa Nr. 18766/11 dhe 36030/11 (GJEDNJ, 21 korrik 2015); Fedotova dhe të tjerë kundër Rusisë, Kërkesa Nr. 40792/10, 30538/14 dhe 43439/14 (GJEDNJ, 17 janar 2023); *Buhuceanu dhe të tjerë kundër Rumanisë*, Kërkesa Nr. 20081/19 dhe 20 të tjerë (GJEDNJ, 23 maj 2023).

³⁰ Rekomandimi CM/Rec(2010)5 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, rekomandimi (2).

³¹ Rezoluta 2048 (2015) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për diskriminimin ndaj personave transgjinorë në Evropë, Teksti i miratuar nga Asambleja më 22 prill 2015 (Seanca e 15-të).

³² Rezoluta 2191 (2017) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për promovimin e të drejtave të njeriut dhe eliminimin e diskriminimit ndaj personave interseks, Teksti i miratuar nga Asambleja më 12 tetor 2017 (Seanca e 35-të).

³³ Rezoluta 2239 (2018) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për jetën private dhe familjare: Arritja e barazisë pavarësisht nga orientimi seksual, tekst i miratuar nga Asambleja më 10 tetor 2018 (Seanca e 3-të).

³⁴ Rezoluta 2417 (2022) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për luftën kundër urrejtjes në rritje ndaj personave LGBTI në Evropë, Teksti i miratuar nga Asambleja më 25 janar 2022 (Seanca e 3-të).

³⁵ Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, Rezoluta 380(2015) mbi Garantimin e të drejtave të lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transgjinorëve (LGBT): një përgjegjësi për qytetet dhe rajonet e Evropës; Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, Rezoluta 470(2021) për Mbrojtjen e personave LGBTI në kontekstin e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit ndaj LGBTI në rritje: Roli i autoriteteve lokale dhe rajonale.

justifikuar gjuhën e urrejtjes ose çdo formë tjetër diskriminimi, sidomos për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor.³⁶

³⁶ Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, Rezoluta 380 (2015) mbi Garantimin e të drejtave të lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transgjinorëve (LGBT): një përgjegjësi për qytetet dhe rajonet e Evropës, (2). I njëjti argument u përdor nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen *Beizaras dhe Levickas kundër Lituanisë*, Kërkesa Nr. 41288/15 (GJEDNJ, 14 janar 2020).

Për më tepër, Komisionerët e njëpasnjëshëm për të Drejtat e Njeriut, përmes mandateve të tyre për të promovuar ndërgjegjësimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut në të gjitha shtetet anëtare, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në sqarimin se si zbatohet mbrojtja e të drejtave të njeriut për personat LGBTI në Evropë, duke ndihmuar shtetet anëtare që të miratojnë politika gjithëpërfshirëse LGBTI dhe duke identifikuar shkeljet e të drejtave kur ato ndodhin, nëpërmjet deklaratave, raporteve të vizitave në vend, komenteve për të drejtat e njeriut dhe Dokumentet Kyçe.³⁷ Komisioni Evropian për Demokracinë përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) ka mbajtur një qëndrim gjithnjë e më shumë të fortë në mbrojtje të të drejtave të personave LGBTI, sidomos aty ku ka kufizime për njohjen me informacionin ose censurimin e informacionit në lidhje me orientimin seksual dhe identitetin gjinor.³⁸

³⁷ Shihni p.sh. *Të drejtat e njeriut dhe identiteti gjinor*, CommDH/IssuePaper (2009), Publikimi i Këshillit të Evropës, 2009); *Diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor në Evropë* Botimi i , 2^{te}, (Publikim i Këshillit të Evropës, 2011); *Të drejtat e njeriut dhe personat interseks – Dokument kyç* (Publikim i Këshillit të Evropës, 2015).

³⁸ Komisioni Evropian për Demokracinë përmes Ligjit, Opinioni i Hungarisë mbi Pajtueshmërinë me Standardet Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut të Aktit LXXIX që Ndryshon Disa Akte për Mbrojtjen e Fëmijëve, Opinion Nr. 1059 / 2021 CDL-AD(2021)050, miratuar në Seancën plenare të 129^{te} (Venecia/online, 10-11 dhjetor 2021). Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit, Opinion mbi Çështjen e Ndalimit të të ashtuquajturës "Propagandë të Homoseksualitetit" në dritën e Legjislacionit të fundit në disa Shtete Anëtare të Këshillit të Evropës, Opinion 707 / 2012 CDL- AD(2013) 022, miratuar në seancën plenare të 95^{-te} (Venecia, 14-15 qershor 2013).

III. Sfidat e vazhdueshme për të drejtat e njeriut të personave LGBTI në zonën e Këshillit të Evropës

23. Ndërsa ECRI i mirëpret këto përparime të rëndësishme, ai gjithashtu pranon se mbeten shumë sfida serioze. Ashtu si me shembujt e progresit, sfidat e vazhdueshme për të drejtat e njeriut të personave LGBTI në Evropë janë shumëplanëshe, duke kufizuar kështu përfshirjen sociale, mbrojtjen ligjore dhe pjesëmarrjen në të gjitha sferat e jetës së personave LGBTI.

24. ECRI gjithashtu pranon rëndësinë e identifikimit, planifikimit dhe kundërveprimit të burimeve të reja ose në zhvillim të intolerancës dhe diskriminimit ndaj personave LGBTI. Për shembull, ndërsa përparimet në teknologji kanë potencialin të rritin gëzimin e të drejtave të njeriut dhe pjesëmarrjen sociale të personave LGBTI, disa forma të teknologjisë, si inteligjenca artificiale, sidomos njohja e fytyrës dhe sistemet algoritmike, mund të përdoren gjithashtu për të cenuar privatësinë, sigurinë dhe barazinë e personave LGBTI.

Mungesa e të dhënave të besueshme dhe politikave adekuate

25. Në të gjithë zonën e Këshillit të Evropës, ka mungesë të të dhënave në lidhje me prevalencën, situatat personale (p.sh. gjendja shëndetësore, ekonomike dhe arsimore), karakteristikat e ndërthurura dhe përvojat e jetuara të personave LGBTI. Kjo mungesë e të dhënave është veçanërisht e dukshme në lidhje me gratë lesbike, biseksuale, transgjimore dhe interseksuale. Mund të lindë si nga indiferenca e nëpunësve publikë për mbledhjen e të dhënave për orientimin seksual, identitetin gjinor dhe karakteristikat seksuale, ashtu edhe nga frika e disa personave për zbulimin e statusit të tyre LGBTI ndaj palëve të treta, duke përfshirë edhe ato në pozicione autoriteti. Megjithatë të dhënat e shfaqura, të cilat ekzistojnë, tregojnë për probleme të rëndësishme për personat LGBTI në të gjithë Evropën, boshllëqet në mbledhjen sistematike dhe të besueshme të të dhënave për personat LGBTI shtojnë vështirësitë – si në parandalimin e diskriminimit anti-LGBTI, ashtu edhe në hartimin e masave të përshtatshme për të promovuar gëzimin e të drejtave të njeriut nga personat LGBTI.

26. Pa kuptuar në mënyrë të qëndrueshme dhe të bazuar në të dhëna përvojat e jetuara dhe sfidat me të cilat përballen personat LGBTI, sidomos ata që përjetojnë diskriminim të ndërthurur, siç janë personat që i përkasin komunitetit Rom dhe Udhëtarë, politikëbërësit nuk janë të pajisur për të identifikuar dhe për të synuar në mënyrë efektive nevojat aktuale të kësaj popullate të larmishme. Rezultati është një rritje e gjasave që politikat të miratohen bazuar në stereotipe ose supozime. Ky rrezik rritet në rastin e femrave lesbike, biseksuale, transgjinore dhe interseks, të cilat, për shkak të problemeve në rekrutimin dhe kontaktin për mbledhjen e të dhënave, mund të jenë të pamjaftueshme ose të nënëpërfaqësuar në të dhënat aktuale lokale, rajonale dhe kombëtare. Gjithashtu, në mungesë të të dhënave gjithëpërfshirëse për orientimin seksual, identitetin gjinor dhe karakteristikat seksuale, është gjithnjë e më e lehtë për kundërshtarët që të hedhin poshtë të drejtat e njeriut të personave LGBTI si shqetësime të vogla ose marginale. ECRI ripohon se mungesa e të dhënave nuk tregon që personat LGBTI nuk vuajnë nga intoleranca, dhuna dhe abuzime të tjera.

27. Çështja e dukshmërisë dhe e të dhënave të besueshme është veçanërisht e ngutshme në kontekstin e personave interseks. Në shumë vende Evropiane, pavarësisht përkrahjes në rritje dhe dënimit formal, ka pasur sukses të kufizuar në parandalimin e kryerjes së procedurave mjekësore jo-terapeutike ose të ashtuquajtura procedura "normalizuese të seksit" të fëmijët interseks pa pëlqimin e tyre të lirë dhe të informuar dhe pa informacion të duhur në lidhje me efektet e mundshme fizike dhe mendore mbi personat në fjalë ose prindërit dhe kujdestarët e tyre.³⁹ Ndërsa një numër shtetesh anëtare kanë miratuar masa për të ndaluar ose kufizuar këto ndërhyrje, praktika mbetet kryesisht e paeksploruar dhe shpesh është në diskrecion dhe objekt rregullimi i organeve mjekësore vendase dhe mjekëve individualë. Këto procedura të ashtuquajtura "normalizuese", kur kryhen për arsye sociale – të tilla si ankthi prindëror, preferencat estetike ose stigmatizimi i parashikuar në të ardhmen⁴⁰ – dhe pa një justifikim legjitim terapeutik, përbëjnë shkelje të qartë të të drejtave të njeriut.⁴¹ Ato mund të çojnë në pasoja të përvetshme për personat interseks, sidomos sterilizimin, shenjat e rënda, humbjen e funksionit seksual, traumën psikologjike dhe nevojën për trajtim të gjerë pasues.⁴²

³⁹ Rezoluta 2191 (2017) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për promovimin e të drejtave të njeriut dhe eliminimin e diskriminimit ndaj personave interseks, Teksti i miratuar nga Asambleja më 12 tetor 2017 (Seanca e 35-të); Rezoluta e Parlamentit Evropian e 14 shkurtit 2019 mbi të drejtat e personave interseks (2018/2878(RSP))

⁴⁰ Shihni në përgjithësi: Rezoluta 2191 (2017) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për promovimin e të drejtave të njeriut dhe eliminimin e diskriminimit ndaj personave interseks, Teksti i miratuar nga Asambleja më 12 tetor 2017 (Seanca e 35-të)

⁴¹ Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, *Të Drejtat e Njeriut dhe Personat Interseks – Dokument Kyç* (Publikim i Këshillit të Evropës, 2015)

⁴² Rezoluta 2191 (2017) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për promovimin e të drejtave të njeriut dhe eliminimin e diskriminimit ndaj personave interseks, Teksti i miratuar nga Asambleja më 12 tetor 2017 (Seanca e 35-ë).

Procedurat mjekësore të panevojshme dhe të pavullnetshme ngrenë shqetësime të rëndësishme për të drejtat për dinjitet, paprekshmëri trupore, dhe mbrojtje nga trajtimi çnjerëzor ose poshtërues.⁴³

28. Në përgjithësi, nga sondazhet del gjithashtu se, edhe kur shtetet anëtare kanë miratuar politika në favor të sigurisë dhe barazisë LGBTI, popullatat në fjalë mund të vazhdojnë të përjetojnë shkallë të lartë të dhunës dhe diskriminimit. Për shembull, gjetjet nga një sondazh në 28 vendet e atëhershme të Bashkimit Evropian, plus Serbinë dhe Maqedoninë e Veriut, zbuluan se 38% e të anketuarve kishin përjetuar ngacmime vitin e kaluar sepse ishin persona LGBTI. Në të njëjtin kërkim, 21% e të anketuarve treguan se ndiheshin të diskriminuar në punë sepse ishin LGBTI dhe 37% e të anketuarve ndiheshin të diskriminuar po njësoj në fusha të tjera përveç punësimit.⁴⁴ Këto gjetje gjithashtu ilustronë kufijtë e mundshëm të ndërhyrjeve ligjore formale dhe ato sugjerojnë që, pavarësisht nga niveli i mbrojtjes ekzistuese, një numër i konsiderueshëm i personave LGBTI në Evropë vazhdojnë të jetojnë në situata të pabarazisë, rrezikut dhe dhunës.⁴⁵

Nevoja për veprime më të vendosura në fushën e arsimit gjithëpërfshirës

29. Studentët LGBTI⁴⁶ ndikohen ndjeshëm nga shkalla ku çështjet e orientimit seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikave seksuale, ose çështjet që kanë të bëjnë me diversitetin në format e familjes, nuk janë të integruara në politika dhe praktika që rregullojnë të gjitha nivelet e arsimit. Një qasje e ndjeshme, e përshtatshme për moshën dhe e hapur ndaj gjinisë dhe seksualitetit mund të nxisë respektin për studentët LGBTI dhe të parandalojë kulturat e bullizimit,

⁴³ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, *M kundër Francës*, Kërkesa Nr. 42821/18 (GJEDNJ, 19 maj 2022); Raportuesi Special për torturën dhe trajtimet ose dënimet e tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, *Raporti i Raportuesit Special për torturën dhe trajtimet ose dënimet e tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese*, Dok. i OKB-së Nr A/HRC/31/57 (5 janar 2016). Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk ka vendosur ende nëse ndërhyrjet e ashtuquajtura "normalizuese" janë në përputhje me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Megjithatë, në një vendim ku GJEDNJ përfundimisht u shpreh se kërkesa ishte e papranueshme, shihni diskutimin e GJEDNJ-së për këto procedura në kontekstin e nenit 3; Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, *M kundër Francës*, Kërkesa Nr. 42821/18 (GJEDNJ, 19 maj 2022).

⁴⁴ Agjencia për të Drejtat Themelore e Bashkimit Evropian, BE-LGBTI: Një rrugë e gjatë për barazinë LGBTI, Luksemburg, Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian (2020)

⁴⁵ Shihni p.sh. Marie-Anne Valfort, *LGBTI në vendet e OECD: Një Vlerësim*, Dokumentet e Punës të OECD, Punësimi dhe Migracioni, Nr. 198 (2017, Publikim i OECD, Paris); Komisioni i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për Barazinë dhe Mosdiskriminimin, *Lufta kundër urrejtjes në rritje ndaj personave LGBTI në Evropë* (Dok. Nr. 15425, 17 dhjetor 2021); Rezoluta 2417 (2022) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për luftën kundër urrejtjes në rritje ndaj personave LGBTI në Evropë, Teksti i miratuar nga Asambleja më 25 janar 2022 (Seanca e 3-të)

⁴⁶ Ndërkohë që, për qëllimet e GPR Nr. 17, pranon se ekzistojnë dallime thelbësore mes studentëve në kontekste të ndryshme dhe se këto kontekste do të formësojnë mënyrën se si studentët përjetojnë diskriminimin dhe intolancën ndaj LGBTI-ve, ECRI përdor termin "studentë LGBTI" për të përfshirë të gjithë studentët LGBTI, duke përfshirë ata që janë në arsimin parashkollor dhe në kopsht, si dhe, sipas rastit, nxënësit me prindër LGBTI

ngacmimit, diskriminimit dhe dhunës. Në të kundërt, politikat arsimore të bazuara në heshtje ose stigmatizim mund të përforcojnë marginalizimin e studentëve LGBTI dhe ato legjitimojnë paragjykimet anti-LGBTI.⁴⁷ Këto mjedise krijojnë stres akut dhe kronik dhe kanë efekt negativ në shëndetin dhe mirëqenien fizike dhe mendore të studentëve LGBTI.

30. Në shumë vende Evropiane, kurrikulat arsimore i referohen pak personave LGBTI dhe formave të ndryshme të familjes, qoftë për shkak të ndalimeve formale ose si pasojë e luhatjeve zyrtare. Mungesa, qoftë e qëllimshme apo jo, e burimeve arsimore gjithëpërfshirëse të përshtatshme për moshën, duke përfshirë marrëdhëniet gjithëpërfshirëse dhe edukimin seksual, përforcon izolimin social dhe shërben për të dalluar studentët e rinj LGBTI nga bashkëmoshatarët e tyre.⁴⁸ Në të gjithë Evropën, studentët LGBTI janë veçanërisht të pambrojtur nga ngacmimi, dhuna dhe abuzimi,⁴⁹ shpesh si pasojë e injorancës dhe keqkuptimit rreth orientimit seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikave seksuale. Arsimi gjithëpërfshirës është një faktor i rëndësishëm në parandalimin e këtyre keqkuptimeve. Duke i hequr studentëve mundësinë për të mësuar rreth ideve të respektit, transparencës dhe gjithëpërfshirjes mund të arrihet vetëm në bullizim dhe abuzim të mëtejshëm.

Mungesa e njohjes formale dhe mbrojtjes së çifteve të të njëjtit seks dhe lidhjeve familjare LGBTI

31. Pavarësisht përparimeve të konsiderueshme vitet e fundit, ka një numër shtetesh anëtare të Këshillit të Evropës që nuk njohin ose mbrojnë formalisht lidhjet familjare LGBTI. Në këto vende, marrëdhëniet ndërmjet çifteve të të njëjtit seks janë të privuara nga statusi ligjor, duke përfshirë martesën, partneritetin e regjistruar ose bashkëjetesën. Personat LGBTI mund të zbulojnë gjithashtu se marrëdhënia e tyre me të njëjtin seks, e zyrtarizuar në një shtet anëtar, nuk njihet ligjërisht kur ata lëvizin në një vend tjetër Evropian.⁵⁰ Në praktikë, mungesa e njohjes ligjore ekspozon çiftet e të njëjtit seks ndaj cenueshmërisë sociale dhe financiare, ku u mungon akses i edhe në përfitimet bazë sociale dhe ku mund t'u mohohet e drejta për të marrë vendime të rëndësishme për të afërmin, sidomos zgjedhjet në lidhje me kujdesin urgjent mjekësor.

⁴⁷ I sigurt në shkollë: Përgjigjet e fushës së arsimit ndaj dhunës bazuar në orientimin seksual, identitetin/shprehjen gjinore ose karakteristikat seksuale në Evropë (Këshilli i Evropës, 2018), 37-39. Shihni gjithashtu: Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, Koment për të Drejtat e Njeriut, "Edukimi gjithëpërfshirës i seksualitetit mbron fëmijët dhe ndihmon në krijimin e një shoqërie më të sigurt, përfshirëse" (21 korrik 2020)

⁴⁸ Shihni UNESCO, *Udhëzues teknik ndërkombëtar për edukimin seksual: një qasje e bazuar në të dhëna* (UNESCO, 2018) <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000260770>

⁴⁹ I sigurt në shkollë: Përgjigjet e fushës së arsimit ndaj dhunës bazuar në orientimin seksual, identitetin/shprehjen gjinore ose karakteristikat seksuale në Evropë (Këshilli i Evropës, 2018), 22-24

⁵⁰ Shihni p.sh Vendim i 5 qershorit 2018, *Coman*, C673/16, EU:C:2018:385; *Relu-Adrian Coman dhe të tjerë kundër Rumanisë*, Kërkesa Nr. 2663/21 (GJEDNJ, Komunikuar më 9 shkurt 2021)

32. Personat LGBTI mund të kenë gjithashtu pak mbrojtje në lidhje me fëmijët e tyre. Të përfshirur nga të gjitha rrugët formale për krijimin e një familjeje, si birësimi dhe riprodhimi i asistuar, këtyre individëve LGBTI, veçanërisht prindërve jobiologjikë, u mungon siguria për njësitë e tyre ekzistuese familjare dhe atyre mund t'u privohet t'i afrohen fëmijëve të tyre pa mjete ligjore efektive. Kjo ka edhe pasoja negative për të drejtën e fëmijëve për të gëzuar jetën familjare. Në një sërë shtetesh anëtare, prindërve LGBTI mund t'u hiqet statusi ligjor si prind edhe pse ky status është vendosur në formë të vlefshme në një shtet tjetër anëtar.⁵¹

33. Disa shtete anëtare tani po shfuqizojnë, ose nuk po zbatojnë ligjet e miratuara më parë, të cilat mbrojnë të drejtat e njeriut të personave LGBTI. Kjo tërheqje, e cila është e dukshme në sferën e jetës familjare dhe fusha të tjera të ligjit, redukton ndjeshëm sigurinë dhe barazinë e personave LGBTI.⁵² Ka gjithashtu të dhëna në rritje nga juridiksionet kombëtare që refuzojnë të zbatojnë masat kryesore mbrojtëse për personat LGBTI, siç janë të drejtat e partneritetit⁵³ dhe të drejtat e prindërimit,⁵⁴ dhe liria për të shprehur një identitet LGBTI,⁵⁵ edhe kur kjo kërkohet nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ose Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian.

Mos-sigurimi i njohjes ligjore të gjinisë dhe mbrojtjes së personave transgjinorë

34. Në një sërë vendesh Evropiane, aksesit në mbrojtje ligjore, veçanërisht të synuar për të mbuluar popullatat transgjinore, siç është e drejta për njohjen ligjore të gjinisë, është i kushtëzuar me plotësimin e parakushteve abuzive ose invazive nga një person.⁵⁶ Këto parakushte për akses në të drejtat themelore, në varësi të juridiksionit, mund të marrin një sërë formash të ndryshme, të tilla si detyrimet për t'ju nënshtruar trajtimit mjekësor ose operacionit të padëshiruar, sterilizimit, divorcit të detyrueshëm nga martesat ekzistuese ose pagesave të tarifave të konsiderueshme. Kërkesat shpeshherë funksionojnë si një pengesë e pakapërcyeshme për shumë persona transgjinorë që duan të

⁵¹ Vendimi i 14 dhjetorit 2021, *V.M.A.*, C490/20, EU:C:2021:1008. Shihni gjithashtu: Alina Tryfonidou dhe Robert Wintemute, *Pengesat ndaj lëvizjes së lirë të familjeve ylber në BE: Studim i kërkuar nga Komiteti PETI* (Bashkimi Evropian, 2021)

⁵² Shihni p.sh Bill Omnibus T/9934 (maj 2020), neni 3, Hungari; Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë, Dosja Kushtetuese nr. 3/2018, Vendim nr. 13 (27 korrik 2018); projekt ligj nr. 301/1995 (mars 2023), Sllovaki

⁵³ Relu-Adrian Coman dhe të tjerë kundër Rumanisë, Kërkesa Nr. 2663/21 (GJEDNJ, Komunikuar më 9 shkurt 2021); Vendimi i 5 qershorit 2018, *Coman*, C673/16, EU:C:2018:385.

⁵⁴ Vendimi i 14 dhjetorit 2021, *V.M.A.*, C490/20, EU:C:2021:1008.

⁵⁵ *Bayev dhe të tjerë kundër Rusisë*, Kërkesa Nr. 67667/09 (GJEDNJ, 20 qershor 2017).

⁵⁶ *Të drejtat e njeriut dhe identiteti gjinor*, CommDH/IssuePaper (2009), Botime të Këshillit të Evropës, 2009); *Zbatimi i Rekomandimit CM/Rec(2010)5 të Komitetit të Ministrave për masat e luftës kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor - Raport Tematik për Njohjen Ligjore të Gjinisë në Evropë*, dok. GT-ADI-SOGI(2022)7, CDADI, GT-ADI-SOGI

ushtrojnë të drejtat e tyre të njeriut. Gjithashtu ka të dhëna që pavarësisht mbështetjes së përgjithshme për njohjen ligjore të gjinisë, qëndrimet publike në një numër vendesh Evropiane janë ngurtësuar kundër kësaj të drejte thelbësore të njeriut.⁵⁷

Mungesa e garancive ligjore për personat interseks

35. Mungesa e masave të mbrojtjes për personat interseks është veçanërisht akute. Pak vende Evropiane ofrojnë mbrojtje të shprehur për personat interseks përmes përfshirjes së "karakteristikave seksuale" si bazë formale në ligjet e barazisë dhe kundër diskriminimit, si edhe ligjet për luftën kundër gjuhës së urrejtjes dhe krimeve të urrejtjes. Në juridiksione të tjera, mbetet një pyetje e hapur nëse gjykatat e brendshme do të interpretonin mbrojtjen ekzistuese të "seksit" ose "gjinisë" për të përfshirë trajtimin e pabarabartë të personave interseks. Kjo situatë i shtohet pozitës së pasigurt ku mund të gjenden personat interseks në të gjithë Evropën.⁵⁸

Të drejtat e fëmijëve dhe ekspozimi i personave LGBTI ndaj praktikave të konvertimit

36. Një fushë veçanërisht shqetësuese është mbrojtja e fëmijëve LGBTI, si dhe e atyre të rinjve që kanë prindër ose kujdestarë LGBTI.⁵⁹ Këta fëmijë dhe adoleshentë mund të përjashtohen, plotësisht ose pjesërisht, nga ligjet përfshirëse të LGBTI-së dhe nevojat dhe dëshirat e tyre shumë shpesh i nënshtrohen paragjykimave dhe anshmërive të të rriturve. Një situatë e tillë është në kundërshtim me parimin bazë të të drejtave të njeriut që, në të gjitha veprimet në lidhje me fëmijët, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata parësore.⁶⁰

37. Të rinjtë LGBTI janë veçanërisht të pambrojtur nga praktika të konvertimit. Këto ndërhyrje shumë joetike, të cilat nganjëherë quhen të ashtuquajtura "terapi konvertimi", synojnë të ndryshojnë orientimin seksual dhe/ose identitetin gjinor të individëve. Praktikave të konvertimit mund të përfshijnë forma të shumta sjelljeje, duke përfshirë keqtrajtim fizik, emocional ose psikologjik, dhe ato gjithashtu mund të kryhen kundër të rriturve LGBTI.

⁵⁷ *Eurobarometri Special 493 – Diskriminimi në Evropë: Raport Publikimi* (Komision i Bashkimit Evropian, 2019), 128-131

⁵⁸ *Të drejtat për barazi trans dhe interseks në Evropë – një analizë krahasuese* (Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, 2018); *Të Drejtat e Njeriut dhe Personat Interseks – Dokument Kyç* (Publikim i Këshillit të Evropës, 2015). Në vitin 2022, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ndërsa hodhi poshtë një kërkesë për shkaqe pranueshmërie, sugjeroi se do të mbronte paprekshmërinë trupore të fëmijëve dhe të të rinjve interseks në një proces gjyqësor të përshtatshëm. Shihni: Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, *M kundër Francës*, Kërkesa Nr. 42821/18 (GJEDNJ, 19 maj 2022)

⁵⁹ Shihni p.sh. Këshilli i Evropës, *Strategjia e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijëve (2022-2027)* (Këshilli i Evropës, 2022), 23.

⁶⁰ Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, Neni 3 (1)

Praktikat e konvertimit janë dënuar nga aktorët e të drejtave të njeriut,⁶¹ dhe ato janë të ndaluara në një numër në rritje vendesh Evropiane.⁶² Edhe pse joefektive në arritjen e qëllimeve të tyre të deklaruara, praktikat e konvertimit mund të kenë ndikime negative gjatë gjithë jetës në mirëqenien mendore dhe fizike të personave LGBTI. Ato cenojnë të drejtat e personave LGBTI për të jetuar me dinjitet dhe pa trajtim çnjerëzor ose poshtërues.

Trajtimi i papërshtatshëm i kërkesave për azil nga personat LGBTI

38. Brenda sferës së ligjit për azilin dhe refugjatët, frika e bazuar nga persekutimi ose keqtrajtimi për shkak të të qenit LGBTI njihet si shkak për azil.⁶³ Megjithatë, edhe në vendet ku ekziston kjo njohje, ka të dhëna që autoritetet mund t'i nënshtrojnë individët ndaj vlerësimeve abuzive me qëllim që të përcaktojnë "besueshmërinë" e orientimit të tyre seksual.⁶⁴ Kjo përfshin, por jo vetëm, marrjen në pyetje në formë ndërhyrëse, testimin psikologjik dhe nxjerrjen e konkluzioneve disproporcionale ku njerëzit nuk arrijnë të ngrenë fillimisht motivin e fobisë ndaj LGBTI-së për përvojën e tyre të persekutimit. Këto vlerësime janë diskretituese dhe kanë një ndikim joproporcional mbi personat LGBTI, të cilët mund të përjetojnë forma të ndërthurura të diskriminimit për shkak të "racës", origjinës etnike ose kombëtare, shtetësisë dhe fesë. Në të gjithë zonën e Këshillit të Evropës refugjatët dhe azilkërkuesit LGBTI mund të përjetojnë gjithashtu diskriminim dhe intolerancë jashtë procedurave të vlerësimit të azilit, duke përfshirë strehimin e pasigurt, aksesin e kufizuar në kujdesin e nevojshëm shëndetësor dhe pengesat për sigurimin e njohjes ligjore.

39. ECRI vëren se, edhe në shtetet anëtare që njohin personat LGBTI si refugjatë, disa kontekste mund të paraqesin ende një rrezik persekutimi ose keqtrajtimi. Për shembull, në vendet ku ekzistojnë ligje ose sanksione ligjore kundër personave LGBTI, por në përgjithësi nuk zbatohen, mund të ekzistojë

⁶¹ Raport i Ekspertit të Pavarur për mbrojtjen nga dhuna dhe diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, *Praktikat e të ashtuquajturës "terapia e konvertimit"*, Dok. i OKB-së A/HRC/44/53 (1 maj 2020). Shihni gjithashtu: Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, "Asgjë për të kuruar: duke i dhënë fund të ashtuquajturave 'terapi të konvertimit' për personat LGBTI" (16 shkurt 2023) [https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/ nothing-to-cure-putting-an-end-to-so-called-conversion-therapies-for-lgbti-people](https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/nothing-to-cure-putting-an-end-to-so-called-conversion-therapies-for-lgbti-people)

⁶² Shihni p.sh. *Ndalimet ndaj "terapiave" të konvertimit Situata në shtetet anëtare të përzgjedhura të BE-së*, Informacion i Parlamentit Evropian (Bashkimi Evropian, 2022)

⁶³ Rekomandimi CM/Rec(2010)5 i Komitetit të Ministrave, 42-44. Shihni gjithashtu: Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët, "Udhëzimet për Mbrojtjen Ndërkombëtare Nr. 9 Pretendimet për statusin e refugjatit bazuar në orientimin seksual dhe/ose identitetin gjinor brenda kontekstit të nenit 1A(2) të Konventës së 1951 dhe/ose të Protokollit të saj të vitit 1967 në lidhje me Statusin e Refugjatëve", HCR/GIP/12/09 (UNHRC) (23 tetor 2012)

⁶⁴ Vendimi i 2 dhjetorit 2014, A, B dhe C kundër *Staatssecretaris van Veiligheid en Justitie*, C148/13 deri C150/13, EU:C:2014:2406; Vendimi i 25 janarit 2018, F kundër *Bevondarlassi es Allampolgarsagi Hivatal*, C473/16, EU:C:2018:36. Shihni gjithashtu: Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, Komenti i të Drejtave të Njeriut, "Duhen mendje të hapura për të përmirësuar mbrojtjen e azilkërkuesve LGBTI në Evropë" (Këshilli i Evropës, 11 tetor 2018)

ende rreziku i lëndimit pas kthimit të një personi LGBTI në atë vend. Kjo nënvizon nevojën për vlerësim të kujdesshëm të rrethanave individuale të azilkërkuesve dhe refugjatëve LGBTI, si dhe nevojën për të respektuar të drejtat e tyre të njeriut dhe për t'u mbrojtur kundër diskriminimit, persekutimit dhe keqtrajtimit, duke përfshirë parimin e mos-kthimit.

Shtimi i gjuhës së urrejtjes kundër LGBTI dhe të ashtuquajturat fushata kundër gjinisë

40. Vitet e fundit, disa shtete anëtare kanë parë një rritje në diskursin politik dhe publik, veçanërisht në internet, kundër të ashtuquajturës “ideologji LGBTI” ose “ideologji gjinore”.⁶⁵ Lëvizjet “anti-gjinore” që kundërshtojnë të drejtat e LGBTI shpesh kundërshtojnë fushatat për të drejtat e grave, sidomos për autonomi më të madhe riprodhimi. Ato shpesh bazohen në pretendime të pambështetura që mbrojtja dhe avancimi i të drejtave të grave dhe të drejtave të personave LGBTI minon identitetin kombëtar, lirinë fetare dhe vlerat tradicionale të familjes.⁶⁶ Retorika anti-gjinore dhe anti-LGBTI gjithashtu mund të paraqesë gabimisht të drejtat e njeriut të personave LGBTI, veçanërisht të personave transgjinorë, si kërcënime ose rreziqe ndaj të drejtave të grave dhe fëmijëve. Në të gjithë Evropën, fushatat anti-gjini kanë çuar në fjalime nxitëse publike, sidomos disa komente që mund të cilësohen si intolerante ose me urrejtje ndaj personave LGBTI, veçanërisht personave transgjinorë. Në disa shtete anëtare, gjuha kundër gjinisë është zgjedhur nga politikanët vendas, duke kërkuar të inkurajojnë pakënaqësinë dhe ta portretizojnë veten si mbrojtës të vlerave tradicionale.

41. Aty ku retorika anti-gjinore përqafohet nga partitë politike dhe politikanët në pushtet, paragjykimet ndaj personave LGBTI shpesh intensifikohen në publikun e gjerë, pasi kjo gjuhë shihet se ka një mbështetje zyrtare. Qëndrimet anti-LGBTI gjithashtu rrënjosen më shumë kur ligjet që miratohen prekin në mënyrë thelbësore personat LGBTI dhe të drejtat e tyre, ose ndalojnë qarkullimin e informacionit për personat LGBTI në institucione publike ose mjedise publike. Këto ligje dhe masa jo vetëm që prekin personat e interesuar, por ato gjithashtu krijojnë një klimë mbytëse ku organizatat e shoqërisë civile për LGBTI ndihen gjithnjë e më të frikësuara dhe të kufizuara në punën e tyre informuese dhe ndërgjegjësuere të publikut.

⁶⁵ Rezoluta 2417 (2022) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për luftën kundër urrejtjes në rritje ndaj personave LGBTI në Evropë, Teksti i miratuar nga Asambleja më 25 janar 2022 (Seanca e 3-të)

⁶⁶ Shihni në përgjithësi: *Lufta kundër urrejtjes në rritje ndaj personave LGBTI në Evropë* (Dok. Nr. 15425 17 dhjetor 2021), Komiteti i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për Barazinë dhe Mosdiskriminimin; ECRI, *Raport vjetor mbi aktivitetet e ECRI që mbulon periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2021* (2021), (18)-(22); Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut; Koment për të Drejtat e Njeriut “krenaria vs. poshtërimi: manipulimi politik i homofobisë dhe transfobisë në Evropë” (16 gusht 2021)

Mungesa e përgjegjshmërisë për aktet e gjuhës së urrejtjes kundër LGBTI dhe dhunës së motivuar nga urrejtja

42. Ka të dhëna, sidomos nga një numër çështjesh të trajtuara nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut,⁶⁷ për armiqësi ndaj personave LGBTI në disa shtete anëtare. Kjo është veçanërisht e vërtetë në lidhje me kufizimet në të drejtën për tubim paqësor dhe – nëpërmjet përdorimit të të ashtuquajturave ligje të “propagandës kundër homoseksualëve” – në lidhje me kufizimet ndaj personave LGBTI që shprehin hapur, diskutojnë ose shpërndajnë informacion mbi orientimin seksual, identitetin gjinor ose karakteristikat seksuale.⁶⁸ Ka shumë shembuj të autoriteteve kombëtare dhe të tjera në të gjithë Evropën që ose dështojnë në mbrojtjen e personave dhe grupeve LGBTI nga krimet e urrejtjes, sidomos dhuna ose gjuha e urrejtjes që shkon deri në nxitje të dhunës, veçanërisht në internet, ose refuzojnë të hetojnë dhe të ndjekin penalisht këto krime, kur ato ndodhin, shpesh si përgjigje ndaj përpjekjeve të personave LGBTI për të ushtruar të drejtat e tyre për lirinë e tubimit ose lirinë e shprehjes.

43. Refuzimi ose hezitimi i nëpunësve të zbatimit të ligjit dhe prokurorëve për të parandaluar, hetuar dhe ndjekur penalisht aktet e dhunës dhe aktet e tjera të natyrës kriminale kundër personave LGBTI, i privon personat LGBTI nga të drejtat kryesore të njeriut, duke përfshirë mbrojtjen kundër trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose poshtërues, të para në lidhje me të drejtën për mosdiskriminim.⁶⁹ Mungesa e mbrojtjes dhe përgjegjshmërisë për këto akte dhune dhe akte të tjera kriminale krijon një klimë frike dhe pasigurie për personat LGBTI. Kufizon rëndë pjesëmarrjen e tyre në jetën qytetare, sociale dhe politike të shteteve anëtare. Ky refuzim ose hezitim duhet të kuptohet edhe brenda një konteksti më të gjerë ligjor dhe social Evropian të ngushtimit të mundësive për të diskutuar, shprehur dhe afirmuar të drejtat e njeriut të personave LGBTI. Në të njëjtën kohë që autoritetet në disa shtete anëtare nuk po hetojnë dhe ndjekin penalisht krimet e urrejtjes kundër LGBTI, duke përfshirë gjuhën e urrejtjes kriminale, ato gjithashtu, ndërmjet kufizimeve të tjera, ndalojnë marshimet publike të personave LGBTI, censurojnë libra të lidhur me LGBTI, dhe etiketojnë botimet e LGBTI si të dëmshme për fëmijët.⁷⁰

⁶⁷ *Identoba dhe të tjerë kundër Gjeorgjisë*, Kërkesa Nr. 73235/12 (GJEDNJ, 12 maj 2015); *MC dhe AC kundër Rumanisë*, Kërkesa Nr. 12060/12 (GJEDNJ, 12 prill 2016); *Beizaras dhe Levickas kundër Lituanisë*, Kërkesa Nr. 41288/15 (GJEDNJ, 14 janar 2020); *Oganezova kundër Armenisë*, Kërkesa Nr. 71367/12, Kërkesa Nr. 72961/12 (GJEDNJ, 15 maj 2022)

⁶⁸ *Alekseyev kundër Rusisë*, Kërkesat Nr. 4916/07, 25924/08 dhe 14599/09 (GJEDNJ, 21 tetor 2010); *GenderDoc-M kundër Moldavisë*, Kërkesa Nr. 9106/06 (GJEDNJ, 12 qershor 2012); *Bayev dhe të tjerë kundër Rusisë*, Kërkesa Nr. 67667/09 (GJEDNJ, 20 qershor 2017); *KAOS GL kundër Turqisë*, Kërkesa Nr. 4982/07 (GJEDNJ, 22 nëntor 2016)

⁶⁹ *Identoba dhe të tjerë kundër Gjeorgjisë*, Kërkesa Nr. 73235/12 (GJEDNJ, 12 maj 2015); *Sabalic kundër Kroacisë*, Kërkesa Nr. 50231/13 (GJEDNJ, 14 janar 2021)

⁷⁰ *Lufta kundër urrejtjes në rritje ndaj personave LGBTI në Evropë* (Dok. Nr. 15425 17 dhjetor 2021), Komiteti i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për Barazinë dhe Mosdiskriminimin; *Macate kundër Lituanisë*, Kërkesa Nr. 61435/19

Në disa vende Evropiane, personat mund të rrezikojnë të arrestohen dhe të ndiqen penalisht për pjesëmarrje në demonstrata paqësore të LGBTI dhe jo për kryerjen e akteve të rënda të dhunës ndaj atyre që marrin pjesë në atë demonstratë.

44. Aty ku nuk hetohet dhe ndiqet penalisht dhuna anti-LGBTI, kjo shpesh rezulton nga qëndrimet e paragjykimimit dhe diskriminimit. Megjithatë, mund të jetë edhe pasojë e injorancës, supozimeve të pabazuara dhe keqkuptimeve. Ndërsa, në disa vende Evropiane, ka shembuj pozitivë të trajnimeve të fokusuara në LGBTI për nëpunësit e zbatimit të ligjit,⁷¹ prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore gjyqësorë, disponueshmëria dhe zbatimi i këtyre programeve mbetet i pabarabartë në të gjithë shtetet anëtare. Programe trajnimi të mundshme dhe kompetente nga ana kulturore, të hartuara në konsultim me shoqërinë civile LGBTI dhe të përshtatura për nevojat specifike të nëpunësve të zbatimit të ligjit⁷² dhe aktorëve të tjerë të drejtësisë penale, mund të jenë një mjet efektiv për parandalimin dhe luftën kundër stereotipeve dhe paragjyqimeve anti-LGBTI, dhe krijimin e besimit ndërmjet personave LGBTI. Pa një trajnim të tillë, nëpunësit e zbatimit të ligjit, prokurorët dhe gjyqtarët kanë më shumë gjasa të shohin incidentet dhe krimet anti-LGBTI përndërmjet këndvështrimit të supozimeve të pasakta, keqkuptimeve dhe paragjyqimeve.

(GJEDNJ, 23 janar 2023). Rezoluta 2417 (2022) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për luftën kundër urrejtjes në rritje ndaj personave LGBTI në Evropë, Teksti i miratuar nga Asambleja më 25 janar 2022 (Seanca e 3-të)

⁷¹ Shihni gjithashtu, Këshilli i Evropës, Joanna Perry dhe Paul Franey, *Policimi i krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI: Trajnim për një reagim profesional policor* (Këshilli i Evropës, 2017)

⁷² Në lidhje me këtë, nëpunësit e zbatimit të ligjit mund të përfshijnë punonjësit e burgut dhe personelin tjetër të paraburgimit kur bëhet fjalë për trajnimin dhe zhvillimin e kompetencave për parandalimin dhe luftën kundër diskriminimit ndaj LGBTI, gjuhës së urrejtjes dhe dhunës në vendet e heqjes së lirisë, në veçanti qendrat e ndalimit të imigracionit dhe burgjet. Shihni gjithashtu punën e kryer nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtëruar (CPT).

Rekomandime

ECRI vëren se nivelet dhe format e intolerancës dhe diskriminimit ndaj personave LGBTI ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme ndërmjet shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Rekomandimet e mëposhtme, të cilat gjithashtu marrin parasysh gjetjet nga puna e monitorimit të shtetit nga ECRI, janë synuar të shërbejnë si orientim për të ndihmuar shtetet anëtare që të parandalojnë dhe luftojnë diskriminimin dhe intolerancën ndaj personave LGBTI, në bashkëpunim me komunitetet në fjalë, duke pasur parasysh vështirësitë e veçanta dhe problemet në shtetet e ndryshme anëtare.

ECRI rekomandon që qeveritë e shteteve anëtare:

Parime të përgjithshme

1. t'i japin përparësi të lartë promovimit dhe arritjes së barazisë për personat LGBTI dhe luftës ndaj diskriminimit dhe intolerancës ndaj tyre, duke marrë të gjitha masat pozitive, përfshirë legjisllacionin, politikat administrative dhe strategjitë kombëtare ose planet e veprimit, për të siguruar që personat LGBTI të jenë të sigurt, të mbrohen njësoj me ligj dhe të jenë në gjendje të gëzojnë të drejta dhe liri në të njëjtën masë si të gjithë anëtarët e tjerë të shoqërisë;
2. të sigurojnë që masat e marra për të luftuar diskriminimin dhe intolerancën ndaj personave LGBTI të zbatohen në të gjitha nivelet administrative (lokale/rajonale dhe kombëtare) dhe të lehtësojnë përfshirjen e një game të gjerë aktorësh nga sektorë të ndryshëm të shoqërisë, sidomos sferat ligjore, sociale, fetare, arsimore, të shoqërisë civile dhe kulturore. Këto masa duhet të adresojnë gjithashtu ndikimin e pabarazive gjinore dhe dëmeve me bazë gjinore. Politikat e miratuara për të rritur barazinë gjinore duhet të marrin parasysh përvojat e grave lesbike, biseksuale, transgjinore dhe interseks;
3. të sigurojnë që ligjet dhe politikat kundër krimit të urrejtjes dhe kundër diskriminimit të ofrojnë mbrojtje efektive për personat LGBTI dhe të mos miratojnë ligje ose politika, të cilat viktimizojnë, diskriminojnë ose legjitimojnë urrejtjen ndaj personave LGBTI;
4. të sigurojnë që të gjithë personat dhe grupet LGBTI të mund të shprehin lirisht dhe të kenë akses në pikëpamjet dhe informacionin për të drejtat e tyre dhe pozicionin e tyre në shoqëri, në mënyrë të sigurt dhe pa ngacmime apo sulme, dhe që ata të mbrohen plotësisht nga policia dhe autoritetet e tjera përkatëse;

5. të krijojnë një sistem gjithëpërfshirës, të saktë dhe të besueshëm për mbledhjen e të dhënave relevante dhe të ndara në lidhje me personat LGBTI, duke iu përmbajtur standardeve ndërkombëtare të mbledhjes së të dhënave dhe duke siguruar një perspektivë të ndërthurur dhe respektimin e parimeve të konfidencialitetit, vetë-identifikimit vullnetar dhe pëlqimit të informuar. Të dhënat duhet të mblidhen për përdorim ekskluziv të promovimit të barazisë LGBTI dhe parandalimit dhe luftës ndaj intolerancës dhe diskriminimit ndaj personave LGBTI. Duhet të bëhen përpjekje specifike për t'u siguruar që çdo e dhënë të jetë, për aq sa është e mundur, përfaqësuese e të gjithë popullatës LGBTI, duke përfshirë ata që mund të përjetojnë diskriminimin e ndërthurur, siç janë personat LGBTI që i përkasin komunitetit Roma ose Traveller. Përvojat e personave lesbike, biseksuale, transgjinorë dhe interseks, veçanërisht atyre që identifikohen si gra, duhet të konsiderohen në mënyrë të saktë, adekuate dhe të përshtatshme në proceset e rekrutimit;

6. të zhvillojnë ligje, politika, plane veprimi dhe masa të tjera të bazuara në të dhëna, të cilat pranojnë dhe pasqyrojnë përvojën e jetuar të diskriminimit të personave LGBTI – duke kuptuar se këto përvoja mund të formësohen, ndryshohen ose komplikohen nga aspekte të tjera kyçe të identitetit ose përvojës personale, përfshirë "racën", origjinën etnike ose kombëtare, shtetësinë, gjininë, statusin e aftësisë së kufizuar dhe fenë. Në hartimin e këtyre ligjeve, politikave dhe planeve të veprimit gjithëpërfshirëse dhe efektive për personat LGBTI, qeveritë duhet të përfshijnë një qasje të ndërthurur për formën, strukturën dhe zbatimin e tyre dhe të ndërmarrin vlerësime periodike për të monitoruar zbatimin e kësaj qasjeje;

7. të sigurojnë që ligji kombëtar të përkufizojë dhe të ndalojë në mënyrë efektive diskriminimin bazuar në orientimin aktual ose të perceptuar seksual, identitetin gjinor dhe karakteristikat seksuale dhe t'i ngarkojë autoritetet publike me detyrën për të promovuar barazinë e personave LGBTI dhe për të parandaluar diskriminimin në kryerjen e funksioneve të tyre. Ndalimet e diskriminimit, qoftë civil, administrativ apo penal, duhet të mbulojnë të gjitha fushat e jetës, duke përfshirë arsimin, punësimin, strehimin dhe kujdesin shëndetësor. Autoritetet duhet të sigurojnë që legjislati kundër diskriminimit të shtrihet për të gjithë personat LGBTI, personat e perceptuar si LGBTI, dhe për personat që përjetojnë diskriminim për shkak se shoqërohen me personat ose grupet LGBTI;

8. të zhvillojnë një kuadër ligjor gjithëpërfshirës, përfshirë parashikimet e së drejtës civile, administrative dhe penale, për të parandaluar në mënyrë të efektshme gjuhën e urrejtjes kundër LGBTI, përfshirë gjuhën e urrejtjes online dhe të ndjekin penalisht gjuhën e urrejtjes ndaj LGBTI me natyrë kriminale dhe krime të tjera të urrejtjes. Gjuha e urrejtjes kundër LGBTI-së me natyrë kriminale dhe krimet e tjera të urrejtjes nuk duhet të dënohen më pak se gjuha

e urrejtjes me natyrë kriminale dhe krimet e tjera të urrejtjes të motivuara nga shkaqe të tjera të mbrojtura;

9. të sigurojnë që legjislacioni penal kombëtar të mbulojë aktet e natyrës kriminale me motive anti-LGBTI dhe që çdo motiv i tillë të mund të konsiderohet si rrethanë rënduese në përcaktimin e dënimeve përkatëse;

10. të sigurojnë që ligjet, rregulloret dhe politikat e zbatueshme për ndërmjetësit në internet të mbulojnë në masën e duhur mbrojtjen ndaj diskriminimit kundër LGBTI, gjuhës së urrejtjes dhe krimit të urrejtjes, duke pasur parasysh format e shumta dhe të ndërthurura të diskriminimit;

Politika dhe Koordinimi Institucional

Strategjitë dhe Planet Kombëtare të Veprimit për Barazinë e LGBTI

11. të miratojnë, të zbatojnë dhe të pajisin me burimet e duhura një strategji ose plan veprimi kombëtar për barazinë për të promovuar dhe arritur barazinë dhe për të parandaluar dhe luftuar intolerancën dhe diskriminimin bazuar në orientimin seksual aktual ose të perceptuar, identitetin gjinor dhe karakteristikat gjinore;

12. të sigurojnë që çdo strategji kombëtare ose plan veprimi për barazinë të përcaktojë masa konkrete, të tilla si ligjet e propozuara, udhëzimet e qeverisë, programet e trajnimit, mbështetje financiare dhe fushata të ndërgjegjësimit publik, për të parandaluar gjuhën e urrejtjes kundër LGBTI dhe dhunën e motivuar nga urrejtja, dhe për të arritur barazi të efektshme për personat LGBTI në të gjitha fushat e jetës, duke përfshirë arsimin, punësimin, strehimin dhe kujdesin shëndetësor;

13. të sigurojnë që çdo strategji ose plan veprimi kombëtar për barazinë të zhvillohet, të zbatohet dhe të monitorohet në konsultim të ngushtë me aktorët përkatës të shoqërisë civile, duke përfshirë personat LGBTI;

14. të kryejnë vlerësime të përkohshme dhe përfundimtare të bazuara në të dhëna, të pavarura dhe të disponueshme publikisht të zbatimit të çdo strategjie kombëtare ose plani veprimi për barazinë, me synimin për të ri-rregulluar zbatimin, sipas rastit, ose për të zhvilluar strategji të tilla të mëtijshme bazuar në mësimet e nxjerra, dhe aty ku është e nevojshme për të adresuar kërcënimet e reja ndaj të drejtave të njeriut të personave LGBTI. Vlerësimet e ndërmjetme dhe përfundimtare duhet të monitorojnë efektivitetin e një strategjie kombëtare për barazinë ose plani veprimi për adresimin e diskriminimit e ndërthurur që përjetojnë personat LGBTI;

Jeta private dhe familjare dhe të drejtat e fëmijëve

15. të sigurojnë që të gjithë personat LGBTI të gëzojnë efektivisht të drejtën për jetën private dhe familjare, dhe që e drejta familjare dhe ligjet e tjera të mos diskriminojnë për shkak të orientimit seksual aktual ose të perceptuar, identitetit gjinor ose karakteristikave seksuale;

16. të zgjerojnë njohjen dhe mbrojtjen ligjore për personat LGBTI dhe të sigurojnë që çiftet, të cilët kanë zyrtarizuar marrëdhëniet e tyre ndërmjet të njëjtit seks, të kenë akses të barabartë në të njëjtat të drejta dhe përfitime si individët në marrëdhëniet ndërmjet sekseve të ndryshme të njohura ligjërisht, duke përfshirë të drejtat e pronësisë, mirëmbajtjes dhe trashëgimisë. Personat transgjinorë dhe interseks duhet të kenë të drejtën të krijojnë marrëdhënie juridike në përputhje me gjininë e tyre të njohur ligjërisht;

17. të sigurojnë një kuadër ligjor efektiv për njohjen e partneriteteve LGBTI dhe lidhjeve të tjera familjare të personave LGBTI në situata ndërkufitare;

18. të sigurojnë që interesi më i lartë i fëmijës të jetë konsiderata kryesore në politikëbërje dhe në të gjitha vendimet administrative dhe gjyqësore për fëmijët LGBTI dhe për fëmijët e personave LGBTI;

19. të sigurojnë miratimin e mbrojtjeve efektive kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual aktual ose të perceptuar, identitetit gjinor ose karakteristikave seksuale kur vendosin marrëdhëniet juridike ndërmjet prindërve dhe fëmijëve të tyre. Objektivi duhet të jetë që të mundësohet gëzimi i trajtimit të njëjtë nga personat LGBTI veçanërisht për:

- a. identifikimin e prindërve të ligjshëm të një të mituri;
- b. përcaktimin e atij që ka përgjegjësi ligjore për një të mitur dhe që ka të drejtën e ligjshme për të marrë vendime për një të mitur;
- c. përcaktimin se me kë do të jetojë ose kë do të kontaktojë i mituri;
- d. të drejtën e adoptimit;

20. nëse shtetet anëtare lejojnë përdorimin e teknologjive riprodhuese të asistuara, të ndalojnë diskriminimin në aksesin e këtyre teknologjive për shkak të orientimit seksual aktual ose të perceptuar, identitetit gjinor ose karakteristikave seksuale;

21. të garantojnë që të gjithë fëmijët të kenë të drejtë të shprehin lirisht orientimin e tyre seksual, identitetin gjinor ose karakteristikat seksuale pa diskriminim, veçanërisht në kontekstin e arsimit;

Ndalimi i praktikave të konvertimit

22. të zbatojnë një ndalim ligjor gjithëpërfshirës dhe efektiv, përfshirë reklamimin dhe promovimin, ndaj të gjitha praktikave, të cilat synojnë të konvertojnë ose të ndryshojnë orientimin seksual dhe/ose identitetin gjinor të

fëmijëve, duke përfshirë mënyrën se si fëmijët shprehin orientimin e tyre seksual dhe/ose identitetin gjinor;

23. të sigurojnë masa efektive, duke përfshirë ndalimet ligjore ose kodet profesionale të praktikës, për të siguruar që asnjë i rritur të mos i nënshtrohet praktikave të pavullnetshme ose shtrënguese, të cilat synojnë të konvertojnë ose të ndryshojnë orientimin e tyre seksual dhe/ose identitetin gjinor, përfshirë mënyrën se si ata e shprehin orientimin e tyre seksual dhe/ose identitetin gjinor;

Njohja ligjore e gjinisë dhe e drejta për kujdes shëndetësor për afirmimin e gjinisë

24. të sigurojnë që e drejta kombëtare të garantojë një proces të shpejtë, transparent dhe të aksesueshëm të bazuar në ligje të qarta, të sakta dhe të parashikueshme me anë të të cilave njerëzit mund të sigurojnë njohjen ligjore të gjinisë dhe që individët të mund të ndryshojnë emrin dhe shenjat e seksit në të gjitha dokumentet zyrtare të identitetit, sigurimeve shoqërore dhe dokumente të tjera publike. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që njohja ligjore e gjinisë të jetë e mundur për personat interseks;

25. të garantojnë që njohja ligjore e gjinisë të mos varet nga personat që i nënshtrohen kërkesave abuzive, të tilla si sterilizimi i pavullnetshëm dhe/ose procedurat mjekësore; diagnoza të shëndetit mendor; divorci i detyruar ose humbja e lidhjeve familjare, duke përfshirë statusin prindëror; kosto financiare joproporcionale; ose të dhëna të së ashtuquajturës “përvojë jetësore reale” të jetesës në përputhje me identitetin e tyre gjinor;

26. kur njerëzve u kërkohet t'i nënshtrohen sterilizimit si parakusht për marrjen e njohjes ligjore të gjinisë, të marrin parasysh dhënien e kompensimit për individët në fjalë;

27. të sigurojnë që e drejta kombëtare të ofrojë një rrugë të qartë dhe të kuptueshme përmes së cilës njerëzit, lindja e të cilëve nuk është regjistruar në shtetin anëtar, të mund të marrin njohjen ligjore të gjinisë;

28. të eksplorojnë opsionet për të hequr ose ulur kufizimet e bazuara në moshë për ata që mund të marrin njohjen ligjore të gjinisë;

29. të konsiderojnë futjen e kategorive shtesë gjinore dhe të rishikojnë nevojën për të përfshirë shenjat e gjinisë në dokumente të identitetit, sigurimeve shoqërore dhe dokumente të tjera publike;

30. të sigurojnë që mos-trajtimi në aspektin mjekësor i njohjes ligjore të gjinisë të mos përdoret për të ndaluar kujdesin e nevojshëm shëndetësor për afirmimin e gjinisë për njerëzit që dëshirojnë të ndërmarrin një tranzicion mjekësor. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë, sa më shumë që të jetë e

mundur, që personat transgjjinorë të kenë akses të sigurt, të përballueshëm dhe në kohë në trajtimet e nevojshme për afirmimin e gjinisë;

31. të sigurojnë që rregullat kombëtare që rregullojnë mbulimin e sigurimit për kujdesin shëndetësor që afirmojnë gjininë të mos diskriminojnë për shkak të orientimit seksual aktual ose të perceptuar, identitetit gjinor ose karakteristikave seksuale. Çdo kufizim në mbulimin e sigurimit për kujdesin shëndetësor që afirmon gjininë duhet të respektojë të drejtat për jetën private, mosdiskriminimin dhe standardin më të lartë të mundshëm të shëndetit;

Personat interseks

32. të ndërmarrin hapa për të miratuar masa ligjore gjithëpërfshirëse, efektive dhe bindëse, të cilat ndalojnë kryerjen e operacioneve të panevojshme mjekësore (shpesh të referuara si operacione të ashtuquajtura "normalizuese të seksit") dhe trajtime të tjera jo-terapeutike deri në momentin kur fëmijët interseks janë në gjendje të marrë pjesë në vendime, bazuar në parimin e pëlqimit të lirë dhe të informuar. Ligjet kombëtare duhet të njohin shprehimisht të drejtën e personave interseks për paprekshmëri trupore;

33. të sqarojnë se qëndrimet ose preferencat sociale nuk përbëjnë një justifikim të ligjshëm për kryerjen e procedurave mjekësore joterapeutike në trupat e personave interseks;

34. të sigurojnë që, aty ku personat interseks i nënshtrohen ndërhyrjeve mjekësore jo-konsensuale, ata të kenë akses në të gjithë mbështetjen e duhur, duke përfshirë kujdesin vijues dhe këshillimin nëse kërkohet. Personat që i janë nënshtruar një trajtimi të tillë duhet të kenë akses të plotë në të dhënat e tyre mjekësore;

35. kur operacione të panevojshme mjekësore ose trajtime të tjera janë kryer ndaj personave interseks, pa pëlqimin e tyre të lirë dhe të informuar, të marrin parasysh dhënien e kompensimit për personat në fjalë;

36. të ofrojnë trajnime të përshtatshme për të gjithë profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe politikëbërësit, veçanërisht studentët e mjekësisë, gjë që thekson se personat interseks kanë të drejtën e paprekshmërisë trupore dhe diversitetit. Qeveritë duhet të sigurojnë që personat interseks, duke përfshirë ata që përfshihen në diskriminim të ndërthurur, dhe përfaqësuesit e tyre, të luajnë një rol qendror në zhvillimin e këtyre trajnimeve;

Azili dhe refugjatët

37. të garantojnë që, sipas ligjeve të brendshme të azilit, personat LGBTI, të cilët kanë frikë të bazuar nga persekutimi ose keqtrajtimi për shkak të orientimit seksual aktual ose të perceptuar, identitetit gjinor ose karakteristikave seksuale, të mund të aplikojnë dhe, sipas rastit, pas një

vlerësimi të individualizuar të rrezikut, të marrin statusin e refugjatit. Shtetet Anëtare duhet të mos refuzojnë një kërkesë për azil me arsyetimin që personat LGBTI, nëse kthehen në vendin e tyre të origjinës, mund të shmangin persekutimin ose keqtrajtimin duke fshehur orientimin e tyre seksual, identitetin gjinor ose karakteristikat seksuale;

38. të sigurojnë që personat LGBTI të marrin mbështetjen e duhur në proceset e azilit dhe që ata të mos i nënshtrohen vlerësimeve të papërshtatshme ose abuzive të besueshmërisë, të cilat cenojnë dinjitetin e tyre, përbëjnë diskriminim ose i ekspozojnë ata individë ndaj trajtimit poshtërues. Kjo përfshin, por jo vetëm, testimin psikiatrik; bërjen e pyetjeve të papërshtatshme, të seksualizuara ose stereotipike; kërkesën ose pranimin e materialit të qartë për të vërtetuar se një person është LGBTI; ose nxjerrjen e konkluzioneve joproporcionale nga fakti që kërkesit nuk kanë përcaktuar fillimisht arsyen e fobisë ndaj LGBTI për përndjekjen ose keqtrajtimin e tyre;

39. të sigurojnë trajnime me qëllim që nëpunësit publikë, të cilët shqyrtojnë dhe gjykojnë kërkesat për azil, të kenë njohuri të mjaftueshme për t'u angazhuar me personat LGBTI në një mënyrë të informuar dhe kompetente nga ana kulturore dhe pa supozime stereotipike;

40. të sigurojnë që, ndërsa presin rezultatin e aplikimit të tyre për azil, personat LGBTI të kenë akses në strehim të sigurt dhe ku ata nuk do të përjetojnë diskriminim nga autoritetet ose banorët e tjerë. Qeveritë, sa më shumë që të jetë e mundur, duhet të respektojnë identitetin gjinor, duke përfshirë shprehjen e identitetit gjinor, të njerëzve që kërkojnë azil, si p.sh. përmes ofrimit të kujdesit të duhur shëndetësor, strehimit dhe dokumenteve të identitetit;

Parandalimi

Fushatat ose programet e ndërgjegjësimit për barazinë e LGBTI

41. të promovojnë, të drejtojnë ose të mbështesin, si nëpërmjet mbështetjes financiare, fushatave ose programeve ndërgjegjësuese, sidomos në bashkëpunim me shoqërinë civile, organet e barazisë dhe personat LGBTI, për të rritur ndërgjegjësimin dhe mirëkuptimin e publikut të gjerë për çështjet e barazisë së LGBTI. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë përfshirjen e duhur të të gjithë personave LGBTI, përfshirë gratë lesbike, biseksuale, transgjinore dhe interseks, si dhe personat LGBTI që mund të përjetojnë diskriminim të ndërthurur;

Trajnimi i profesionistëve të medias

42. të inkurajojnë organet rregullatore të medias publike që të organizojnë sesione trajnimi për profesionistët e medias mbi standardet ligjore dhe të tjera

për barazinë LGBTI dhe për luftën kundër gjuhës së urrejtjes ndaj LGBTI, me synim zbatimin e standardeve, veçanërisht në median elektronike. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që ligjet kombëtare, të cilat rregullojnë median, të ndalojnë diskriminimin për shkak të orientimit seksual aktual ose të perceptuar, identitetit gjinor ose karakteristikave seksuale;

Parandalimi dhe lufta kundër fobisë ndaj LGBTI në dhe përmes arsimit

43. të promovojnë përfshirjen e studentëve LGBTI në të gjitha nivelet e arsimit, në konsultim me përfaqësues të sektorit të arsimit dhe shoqërisë civile LGBTI. Kjo duhet të përfshijë zhvillimin e mekanizmave dhe udhëzimeve se si edukatorët dhe administratorët mund të parandalojnë, të hetojnë dhe të korrigjojnë dhunën, bullizmin dhe ngacmimin ndaj studentëve LGBTI, si dhe miratimin e politikës së tolerancës zero ndaj këtyre akteve në fushën e arsimit;

44. të zhvillojnë trajnime të përshtatshme për edukatorët, veçanërisht gjatë shkollimit të tyre profesional, dhe për mësuesit dhe administratorët e shkollave dhe universiteteve për të siguruar që ata të fitojnë njohuri dhe kompetencë të mjaftueshme për të kuptuar dhe përshtatur nevojat e studentëve LGBTI;

45. të sigurojnë që kurrikulat në të gjitha nivelet e arsimit, duke përfshirë marrëdhëniet gjithëpërfshirëse dhe edukimin seksual, të trajtojnë çështjet LGBTI në një mënyrë të ndjeshme, të përshtatshme për moshën dhe lehtësisht të kuptueshme. Diskutimi i çështjeve LGBTI duhet të bazohet në të dhëna dhe të vendosë theks të veçantë mbi barazinë, diversitetin dhe përfshirjen. Autoritetet duhet të shfuqizojnë çdo ligj apo politikë që ndalon shpërndarjen e materialeve të studentët, sepse ato përfshijnë përmbajtje LGBTI;

46. të garantojnë, sa më shumë që të jetë e mundur, që studentët transgjinorë dhe interseks të kenë akses në shërbimet arsimore, duke përfshirë aktivitetet dhe shërbimet jashtëshkollore, në përputhje me identitetin e tyre gjinor;

Rekrutimi gjithëpërfshirës dhe Vendet e Punës

47. të prezantojnë masa efektive, të cilat ndalojnë diskriminimin ndaj personave LGBTI dhe promovojnë diversitetin dhe përfshirjen në fushën e punësimit, duke përfshirë politikat e rekrutimit, kushtet e punësimit, politikat e mbajtjes, mundësitë e promovimit, procedurat disiplinore dhe shkarkimet;

48. të inkurajojnë punëdhënësit e sektorit publik dhe privat që të hartojnë dhe të zbatojnë politika ose kode sjelljeje që synojnë parandalimin dhe luftën ndaj intolerancës dhe diskriminimit ndaj personave LGBTI në aksesin në punësim dhe në vendin e punës, duke përfshirë personat me histori

transgjimore ose ata që ndërmarrin një proces të tranzicionit mjekësor ose social;

Kodet e sjelljes në sferën politike dhe në sektorin e medias

49. të promovojnë miratimin e kodeve të sjelljes nga parlamentet dhe asamblatë e tjera të zgjedhura politikisht, të cilat, duke respektuar ushtrimin e përgjegjshëm të lirisë së shprehjes, refuzojnë gjuhën e urrejtjes kundër LGBTI;

50. të inkurajojnë partitë politike dhe aktorët politikë individualë, veçanërisht ata në pozita udhëheqëse, që të kundërshtojnë në mënyrë aktive gjuhën e urrejtjes ndaj LGBTI, veçanërisht përmes fjalimeve, dhe t'u përmbahen plotësisht parimeve dhe rregullave të përfshira në Kartën e Partive Politike Evropiane për një shoqëri jo-raciste dhe gjithëpërfshirëse të miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës;

51. të inkurajojnë miratimin nga organet e mediave të shkruara dhe elektronike, duke përfshirë mediat online, si dhe nga shoqatat e gazetarëve, të kodeve të sjelljes që kundërshtojnë gjuhën e urrejtjes ndaj personave LGBTI ose mbështetësve të tyre;

Mbrojtja

Liria e shprehjes, liria e tubimit dhe liria e organizimit

52. të sigurojnë që të gjithë personat LGBTI të gëzojnë të drejtën e plotë dhe të barabartë të lirisë së shprehjes, tubimit dhe organizimit, duke u mundësuar atyre të shprehin dhe të diskutojnë publikisht orientimin seksual, identitetin gjinor ose karakteristikat seksuale;

53. të lejojnë dhe të mbrojnë veprime publike paqësore, duke përfshirë marshime, protesta dhe demonstrata, të cilat mbrojnë të drejtat e njeriut të personave LGBTI. Qeveritë duhet të shfuqizojnë çdo ligj ose praktikë administrative, të cilat ndalojnë ose kufizojnë, pa arsye të ligjshme, legjitime dhe të nevojshme, të drejtën e personave LGBTI për t'u përfshirë në veprime të tilla publike ose që i trajtojnë ato veprime në mënyrë më pak të favorshme se marshimet, protestat ose demonstratat e tjera të ligjshme që nuk kanë lidhje me të drejtat e njeriut të personave LGBTI;

54. të miratojnë masa adekuate, duke përfshirë sigurimin e mbrojtjes së përshtatshme policore, për të siguruar që personat LGBTI të mund të ushtrojnë të drejtat e tyre për lirinë e shprehjes, tubimit ose organizimit. Kjo mbrojtje duhet të shtrihet për njerëzit që mbrojnë barazinë e personave LGBTI dhe për

ofruesit e shërbimeve që lehtësojnë ushtrimin e të drejtave të njeriut të personave LGBTI;

55. të shfuqizojnë çdo ligj apo rregull administrativ që ndalon ose kufizon publikimin e materialeve, thjesht sepse ato përfshijnë përmbajtje LGBTI. Çdo vendim për të kufizuar ligjërisht aksesin në materialet e publikuara, duke përfshirë vendosjen e kufizimeve të moshës, duhet të merret pa diskriminim për shkak të orientimit seksual aktual ose të perceptuar, identitetit gjinor ose karakteristikave seksuale;

56. të sigurojnë që shërbimet e mbështetjes së viktimave, duke përfshirë linjat e ndihmës, sistemet e raportimit të incidenteve, shërbimet ligjore dhe të tjera këshillimore dhe strehimoret e viktimave, të jenë të disponueshme për t'u marrë në mënyrë adekuate me viktimat LGBTI të diskriminimit, gjuhës së urrejtjes dhe krimeve të urrejtjes, ose që ato të përfshijnë plotësisht personat LGBTI. Stafi që operon këto shërbime duhet të marrë trajnimin dhe financimin e duhur për të ofruar mbështetje, duke përfshirë trajnimin mbi përvojat e jetuara të grave lesbike, biseksuale, transgjimore dhe interseks, si edhe të personave LGBTI që përjetojnë diskriminim të ndërthurur;

Organet e barazisë dhe Shoqëria Civile

57. të sigurojnë që mandatet e organeve të barazisë të mbulojnë shprehimisht diskriminimin bazuar në orientimin seksual aktual ose të perceptuar, identitetin gjinor ose karakteristikat seksuale. Organet e barazisë duhet të kenë të njëjtat kompetenca, burime dhe përgjegjësi për të ofruar mbrojtje efektive për të drejtat e njeriut të personave LGBTI siç bëjnë për të drejtat e njeriut të grupeve të tjera brenda mandatit të tyre, duke përfshirë të drejtën për të nxjerrë rekomandime dhe për të monitoruar zbatimin e tyre;

58. të sigurojnë që organizatat e shoqërisë civile që promovojnë të drejtat e njeriut të personave LGBTI të jenë në gjendje të regjistrohen dhe të veprojnë pa diskriminim dhe të garantojnë që këto organizata dhe mbrojtësit individual të të drejtave të njeriut që promovojnë barazinë LGBTI, të gëzojnë mbrojtje efektive kundër diskriminimit, gjuhës së urrejtjes, krimeve të urrejtjes dhe abuzimeve ose proces gjyqësor abuziv;

Hetimi, ndjekja penale dhe masat e ligjit procedural

59. të miratojnë dhe të zbatojnë kodet e sjelljes për qeverinë dhe nëpunësit e tjerë publikë përkatës që në mënyrë të shprehur ndalojnë përdorimin e gjuhës që nxit, promovon, përhap ose justifikon dhunën, urrejtjen ose diskriminimin ndaj personave LGBTI ose individëve të lidhur me personat LGBTI, dhe të nxitin, aty ku është e përshtatshme, përdorimin e gjuhës të kundërt dhe gjuhës alternative për ta kundërshtuar këtë. Gjuha që justifikon

ose nxit dhunën dhe urrejtjen kundër personave LGBTI, duke përfshirë gjuhën që është e motivuar nga arsye të ndërlidhura, duhet të hetohet dhe të ndiqet penalisht në përputhje me dispozitat kombëtare të gjuhës së urrejtjes;

60. të sigurojnë që krimet e urrejtjes të kryera ndaj personave LGBTI të hetohen dhe të ndiqen penalisht në mënyrë efektive. Agjencitë e zbatimit të ligjit dhe shërbimet e prokurorisë duhet të miratojnë udhëzime për regjistrimin dhe hetimin e këtyre veprave;

61. të sigurojnë që gjuha e urrejtjes e përdorur në internet dhe e motivuar nga paragjykimi ndaj LGBTI, të dënohet në të njëjtën mënyrë si veprat penale që kryhen jashtë internetit, dhe që gjuha e urrejtjes kundër LGBTI në internet të adresohet në mënyrë adekuate me anë të hetimit efektiv, ndjekjes penale dhe masave të tjera të përshtatshme;

62. të mbështesin trajnimin dhe të zhvillojnë kompetencat për parandalimin dhe luftën kundër diskriminimit ndaj LGBTI, duke përfshirë diskriminimin e ndërthurur, gjuhën e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes për nëpunësit e zbatimit të ligjit,⁷³ prokurorët dhe gjyqtarët, në bashkëpunim dhe konsultim me aktorët përkatës të shoqërisë civile, duke përfshirë organizatat LGBTI dhe organet e barazisë;

63. të sigurojnë që, kur një krim është kryer kundër personave LGBTI, atyre që perceptohen si LGBTI, ose personave që janë të lidhur me personat LGBTI, mundësia që ai të jetë i motivuar nga paragjykimi ndaj LGBTI të hetohet që në fillim dhe të jetë një pjesë e pandarë e hetimit;

64. të ofrojnë mbështetje efektive, të aksesueshme dhe të ndërgjegjshme për viktimat dhe dëshmitarët për të denoncuar krimet e urrejtjes kundër LGBTI. Autoritetet duhet të zbatojnë masa për forcimin e besimit për të rritur bashkëpunimin ndërmjet policisë dhe personave LGBTI, duke përfshirë lehtësimin e dialogut të shtuar (p.sh. takime të rregullta, oficerë ndërlidhës me komunitetin) ndërmjet personave LGBTI dhe agjencive të zbatimit të ligjit.

⁷³ Për qëllimin e këtij rekomandimi specifik, nëpunësit e zbatimit të ligjit mund të përfshijnë personelin e burgjeve dhe personelin tjetër të paraburgimit kur bëhet fjalë për trajnimin dhe kompetencat për parandalimin dhe luftën kundër diskriminimit ndaj LGBTI, gjuhën e urrejtjes dhe dhunën në vendet e heqjes së lirisë

Bibliografia

Këshilli i Evropës

Komisioneri për të drejtat e njeriut

- ▶ *Diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor në Evropë*, botimi i dytë, (Publikim i Këshillit të Evropës, 2011)
- ▶ *Të drejtat e njeriut dhe identiteti gjinor*, CommDH/IssuePaper(2009) (Publikim i Këshillit të Evropës, 2009)
- ▶ *Të drejtat e njeriut dhe personat interseks – Dokument kyç* (Publikim i Këshillit të Evropës, 2015)
- ▶ Koment për të Drejtat e Njeriut, "Edukimi gjithëpërfshirës i seksualitetit mbron fëmijët dhe ndihmon në krijimin e një shoqërie më të sigurt, përfshirëse" (21 korrik 2020)
- ▶ Koment për të Drejtat e Njeriut "Asgjë për të kurrar: duke i dhënë fund të ashtuquajturave 'terapi të konvertimit' për personat LGBTI" (16 shkurt 2023)
- ▶ Koment për të Drejtat e Njeriut "Duhet mendje të hapura për të përmirësuar mbrojtjen e azilkërkuesve LGBTI në Evropë" (11 tetor 2018)
- ▶ Koment për të Drejtat e Njeriut "krenaria vs. poshtërimi: manipulimi politik i homofobisë dhe transfobisë në Evropë" (16 gusht 2021)

Komiteti i Ministrave

- ▶ Rekomandim CM/Rec(2010)5 mbi masat e luftës kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor
- ▶ Strategjia e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijës (2022-2027) (Këshilli i Evropës, 2022)
- ▶ *Zbatimi i CM/Rec(2010)5 për masat e luftës kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor - Raporti Tematik mbi Njohjen Ligjore të Gjinisë në Evropë*, GT- ADI-SOGI(2022)7, Komiteti Drejtues për luftën ndaj Diskriminimit, Diversitetin dhe Përfshirjen (CDADI), Grupi i Punës për orientimin seksual, identitetin gjinor, shprehjen gjinore dhe karakteristikat seksuale (ADI-SOGI- SOGI)

Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale

- ▶ Rezoluta 380(2015) për Garantimin e të drejtave të lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transgjinjorëve (LGBT): një përgjegjësi për qytetet dhe rajonet e Evropës
- ▶ Rezoluta 470(2021) për Mbrojtjen e personave LGBTI në kontekstin e shtimit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit anti-LGBTI: Roli i autoriteteve lokale dhe rajonale

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI)

- ▶ Raport vjetor mbi aktivitetet e ECRI-t që mbulon periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2021 (2021)
- ▶ Fjalorth i ECRI-t, <https://www.coe.int/en/web/European-commission-against-racism-and-intolerance/ecri-glossary>
- ▶ Opinion i ECRI-t për konceptimin e “racializimit”, miratuar në mbledhjen plenare të 87të më 8 dhjetor 2021

Komisioni Evropian për Demokraci Përmes Ligjit (Komisioni i Venecias)

- ▶ Opinion mbi Pajtueshmërinë me Standardet Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut të Aktit LXXIX që ndryshon disa akte për mbrojtjen e fëmijëve, Opinioni nr. 1059 / 2021 CDL-AD(2021)050, miratuar në seancën plenare të 129-të (Venecia/online, 10- 11 dhjetor 2021)
- ▶ Opinion mbi Çështjen e Ndalimit të së ashtuquajturës "Propagandë të Homoseksualitetit" në dritën e Legjislacionit të fundit në disa Shtete Anëtare të Këshillit të Evropës, Opinion 707/2012 CDL- AD(2013) 022, miratuar në seancën plenare të 95-të (Venecia, 14-15 qershor 2013).

Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale

- ▶ Qendra Ndërkombëtare për Mbrojtjen Ligjore të të Drejtave të Njeriut (INTERIGHTS) kundër Kroacisë, Kërkesa nr. 45/2007 (2009).
- ▶ Transgender Evrope dhe ILGA-Evrope kundër Republikës Çeke, Kërkesa nr. 117/2015 (2018).

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

- ▶ Adrian Coman dhe të tjerë kundër Rumanisë, Kërkesa Nr. 2663/21 (GJEDNJ, Komunikuar më 9 shkurt 2021)
- ▶ Alekseyev kundër Rusisë, Kërkesa Nr. 4916/07, 25924/08 dhe 14599/09 (GJEDNJ, 21 tetor 2010)
- ▶ AM dhe të tjerë kundër Rusisë, Kërkesa Nr. 47220/19 (GJEDNJ, 06 korrik 2021)

- ▶ *AP, Garcon dhe Nicot kundër Francës*, Kërkesa Nr. 79885/12 (GJEDNJ, 06 prill 2017)
- ▶ *Bączkowski dhe të tjerë kundër Polonisë*, Kërkesa Nr. 1543/06 (GJEDNJ, 3 maj 2007)
- ▶ *Bayev dhe të tjerë kundër Rosisë*, Kërkesa Nr. 67667/09 (GJEDNJ, 20 qershor 2017)
- ▶ *Beizaras dhe Levickas kundër Lituanisë*, Kërkesa Nr. 41288/15 (GJEDNJ, 14 janar 2020)
- ▶ *Buhuceanu dhe të tjerë kundër Rumanisë*, Kërkesa Nr. 20081/19 dhe 20 (GJEDNJ, 23 maj 2023)
- ▶ *Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa Nr. 7525/7 (GJEDNJ, 22 tetor 1981)
- ▶ *Fedotova dhe të tjerë kundër Rosisë*, Kërkesa Nr. 40792/10, 30538/14 dhe 43439/14 (GJEDNJ, 17 janar 2023)
- ▶ *GenderDoc-M kundër Moldavisë*, Kërkesa Nr. 9106/06 (GJEDNJ, 12 qershor 2012)
- ▶ *Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa Nr. 28957/95 (GJEDNJ, 11 korrik 2002)
- ▶ *Identoba dhe të tjerë kundër Gjeorgjisë*, Kërkesa Nr. 73235/12 (GJEDNJ, 12 maj 2015)
- ▶ *KAOS GL kundër Turqisë*, Kërkesa Nr. 4982/07 (GJEDNJ, 22 nëntor 2016)
- ▶ *Karner kundër Austrisë*, Kërkesa Nr. 40016/98 (GJEDNJ, 24 korrik 2003)
- ▶ *M kundër Francës*, Kërkesa Nr. 42821/18 (GJEDNJ, 19 maj 2022)
- ▶ *Macate kundër Lituanisë*, Kërkesa Nr. 61435/19 (GJEDNJ, 23 janar 2023)
- ▶ *MC dhe AC kundër Rumanisë*, Kërkesa Nr. 12060/12 (GJEDNJ, 12 prill 2016)
- ▶ *Oganezova kundër Armenisë*, Kërkesa Nr. 71367/12, Kërkesa Nr. 72961/12 (GJEDNJ, 15 maj 2022)
- ▶ *Oliari dhe të tjerë kundër Italisë*, Kërkesa Nr. 18766/11 dhe 36030/11 (GJEDNJ, 21 korrik 2015)
- ▶ *OM kundër Hungarisë*, Kërkesa Nr. 9912/15 (GJEDNJ, 5 korrik 2016)
- ▶ *PB dhe JS kundër Austrisë*, Kërkesa Nr. 18984/02 (GJEDNJ, 22 tetor 2010)
- ▶ *Sabalic kundër Kroacisë*, Kërkesa Nr. 50231/13 (GJEDNJ, 14 janar 2021).
- ▶ *Salgueiro da Silva Mouta kundër Portugalisë*, Kërkesa Nr. 33290/96 (GJEDNJ, 21 dhjetor 1999)
- ▶ *Schalk dhe Kopf kundër Austrisë*, Kërkesa Nr. 30141/04 (GJEDNJ, 22 nëntor 2010)

- ▶ *Taddeucci dhe McCall kundër Italisë*, Kërkesa Nr. 51362/09 (GJEDNJ, 30 qershor 2016)
- ▶ *X dhe të tjerë kundër Austrisë*, Kërkesa Nr. 19010/07 (GJEDNJ, 19 shkurt 2013)
- ▶ *X dhe Y kundër Rumanisë*, Kërkesa Nr. 2145/16 (GJEDNJ, 19 janar 2021)
- ▶ *X, Y dhe Z kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa Nr. 21830/93 (GJEDNJ, 22 prill 1997)
- ▶ Fletë Informuese mbi *Homoseksualitetin: Aspektet kriminale, Çështjet e Orientimit Seksual dhe Identitetit Gjinnor*, , Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Shërbimi i Shtypit (*faqja e internetit e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*), <https://www.echr.coe.int/Pages/home.aspx?p=press/factsheets&c>
- ▶ Fletë Informuese Tematike e Departamentit për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, për të drejtat e personave LGBTI <https://rm.coe.int/thematic-factsheet-lgbti-eng/1680a3b2d7>.

Asambleja Parlamentare

- ▶ Rezoluta 2048 (2015) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës mbi Diskriminimin ndaj personave transgjnorë në Evropë, Teksti i miratuar nga Asambleja më 22 Prill 2015 (Seanca e 15-të)
- ▶ Rezoluta 2191 (2017) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për promovimin e të drejtave të njeriut dhe eliminimin e diskriminimit ndaj personave interseks, Teksti i miratuar nga Asambleja më 12 tetor 2017 (Seanca e 35-të)
- ▶ Rezoluta 2191 (2017) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për promovimin e të drejtave të njeriut dhe eliminimin e diskriminimit ndaj personave interseks, Teksti i miratuar nga Asambleja më 12 tetor 2017 (Seanca e 35-të)
- ▶ Rezoluta 2239 (2018) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për jetën private dhe familjare: Arritja e barazisë pavarësisht nga orientimi seksual, Teksti i miratuar nga Asambleja më 10 tetor 2018 (Seanca e 33-të)
- ▶ Komiteti për Barazinë dhe Mosdiskriminimin, Raportues: Fourat Ben Chikha, *Lufta kundër urrejtjes në rritje ndaj personave LGBTI në Evropë* (Dok. Nr. 15425, 17 dhjetor 2021)
- ▶ Rezoluta 2417 (2022) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për luftën kundër urrejtjes në rritje ndaj personave LGBTI në Evropë, Teksti i miratuar nga Asambleja më 25 janar 2022 (Seanca e 3-të).

Publikimet e Këshillit të Evropës

- ▶ Joanna Perry dhe Paul Franey, *Policing Hate Crime kundër personave LGBTI: Training for a Professional Police Response* (Këshilli i Evropës 2017)
- ▶ *Safe at school: Education sector responses to violence based on sexual orientation, gender identity/expression or sex characteristics in Europe* (Këshilli i Evropës 2018, 2018)

Bashkimi Evropian

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian

- ▶ Vendimi i 2 dhjetorit 2014, *A, B dhe C kundër Staatssecretaris van Veiligheid en Justitie*, C148/13 deri C150/13, EU:C:2014:2406
- ▶ Vendimi i 5 qershorit 2018, *Coman*, C673/16, EU:C:2018:385
- ▶ Vendimi i 25 janarit 2018, *F v Bevandorlasi es Allampolgarsagi Hivatal*, C473/16, BE:C:2018:36
- ▶ Vendimi i 14 dhjetorit 2021, *V.M.A*, C490/20, EU:C:2021:1008.

Komisioni Evropian

- ▶ *Sexual Orientation Discrimination Law outside the Labour Market* (Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, 2020)
- ▶ *Eurobarometri Special 493 – Diskriminimi në Evropë: Raport Publikimi* (Komisioni Evropian, 2019)
- ▶ *Trans and intersex equality rights in Europe – a comparative analysis* (Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, 2018)

Parlamenti Evropian

- ▶ Alina Tryfonidou dhe Robert Wintemute, *Obstacles to the Free Movement of Rainbow Families in the EU: Studim i kërkuar nga Komiteti PETI* (Bashkimi Evropian, 2021)
- ▶ *Bans on conversion “therapies” The situation in selected EU Member States*, Informacion i Parlamentit Evropian (Bashkimi Evropian, 2022)
- ▶ Rezoluta e Parlamentit Evropian e 14 shkurtit 2019 mbi të drejtat e personave interseks (2018/2878(RSP))

Agjencia për të Drejtat Themelore (FRA)

- ▶ BE-LGBTI A long way to go for LGBTI equality, Luksemburg, Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, (2020)

Legjislacioni Kombëtar dhe Jurisprudenca

- ▶ Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë, Dosja Kushtetuese Nr. 3/2018, Vendimi nr. 13 (27 korrik 2018)
- ▶ Projekt ligj nr. 301/1995 (mars 2023) Sllovaki
- ▶ Projektligji Omnibus T/9934 (maj 2020) neni 3, Hungari

Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD)

- ▶ Marie-AnneValfort, *LGBTiinOECDCountries:AReview*, OECD Social, Employment and Migration Working Papers, Nr. 198 (2017, Publikim i OECD, Paris)

Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB)

- Raportuesi Special për torturën dhe trajtimet ose dënimet tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, *Raporti i Raportuesit Special për torturën dhe trajtimet ose dënimet e tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese*, Dok i OKB-së Nr. A/ HRC/31/57 (5 janar 2016)
- Raport i Ekspertit të Pavarur për mbrojtjen nga dhuna dhe diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, *Praktikat e të ashtuquajturës “terapia e konvertimit”*, Dok. i OKB-së Nr. A/HRC/44/53 (1 maj 2020)
- UNESCO, *Udhëzues teknik ndërkombëtar për edukimin seksual: një qasje e bazuar në të dhëna* (UNESCO, 2018) <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000260770>
- Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët, “Udhëzimet për Mbrojtjen Ndërkombëtare Nr. 9: Pretendimet për statusin e refugjatit bazuar në orientimin seksual dhe/ose identitetin gjinor brenda kontekstit të nenit 1A(2) të Konventës së 1951 dhe/ose Protokollit të saj të 1967 në lidhje me për Statusin e Refugjatëve”, HCR/GIP/12/09 (UNHRC) (23 tetor 2012)

Sekretariati i ECRI-t
Directorate General of Democracy and Human Dignity Council of
Evrope
Tel.: +33 (0) 3 90 21 46 62
E-mail: ecri@coe.int

www.coe.int/ecri

*Ky përkthim u prodhuan me
mbështetjen financiare të
Bashkimit Evropian dhe të
Këshillit të Evropës. Përmbajtja
e tij është përgjegjësi vetëm e
Këshillit të Evropës dhe nuk
pasqyron domosdoshmërisht
pikëpamjet e Bashkimit
Evropian.*

Bashkimi Evropian është një bashkim ekonomik dhe politik i 27 vendeve evropiane. Ai bazohet në vlerat e respektimit të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përjasin pakicave. Ai vepron globalisht për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërive, mjedisit dhe ekonomive, në mënyrë që të gjithë të mund të përtojnë.

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, 27 prej të cilave janë vende anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, traktat i hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

www.europa.eu

www.coe.int

Përkthimi është bashkëfinancuar
nga Bashkimi Evropian



COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE